

GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT

P. nr. 249/12

01 shkurt 2013

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it, Mariola Pasnik, si kryetare e trupit gjykues, gjyqtari Skënder Çoçaj dhe gjyqtarja Teuta Krusha, si anëtarë të trupit gjykues, me proces-mbajtës Jozef Hollerhead, në lëndën penale kundër të pandehurve:

1. E.K, i akuzuar në bazë të Aktakuzës PPS. nr. 75/2010, të ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës më datë 30.03.2011, dhe të konfirmuar pjesërisht më 29.04.2011 (KA 76/11), me veprën penale të **krimeve të luftës kundër popullatës civile**, në shkelje të neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), tani vepër e dënueshme nga nenet 31 dhe 153 paragrafët (2.1) dhe (2.14) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme “KPRK”), lidhur me Nenin 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12.08.1949 dhe nenin 13.2 të Protokollit II Shtesë të 08.06.1977, të Konventave të Gjenevës të vitit 1949 (Protokolli II Shtesë),

2. MU.H,

3. MI.H,

4. N.H,

5. N.B,

6. J.K,

të gjithë të akuzuar për **dhënie të ndihmës kryerësit pas kryerjes së veprës penale**, në shkelje të nenit 305 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës, tani vepër e dënueshme nga neni 388 (1) dhe (2) i KPRK-së.

7. SO.B, i akuzuar në bazë të Aktakuzës PPS. nr. 75/2010 të ngritur në Gjykatën e Qarkut Prizren nga PSRK më 31.05.2012, me veprën penale të **krimeve të luftës kundër popullatës civile**, në shkelje të neneve 22 dhe 142 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme nga nenet 31 dhe 153 paragrafët (2.1) dhe (2.14) të KPRK-së, lidhur me Nenin 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12.08.1949, dhe nenin 13.2 të Protokollit II Shtesë të 08.06.1977 të Konventave të Gjenevës të vitit 1949 (Protokolli II Shtesë),

pasi mbajti seancat e shqyrtimit gjyqësor të hapur për publikun më 30 nëntor, 4 dhjetor 2012, 10, 24, 25, 28 dhe 29 janar 2013, në praninë e Prokurorit të PSRK-së, Maurizio Salustro, palëve të dëmtuara, dëshmitareve D.Bdhe S.B (më 4 dhjetor 2012), dhe të përfaqësuesit të të dëmtuarve Zharko Gajiq, Avni Berisha dhe Visar Ostrozubi, të pandehurit E.K, mbrojtësit të

tij, avokat Ethem Rugova, të pandehurit MU.H, mbrojtësit të tij, avokat Osman Zajmi, të pandehurit MI.H, mbrojtësit të tij, avokat Brahim Sopa, të pandehurit N.H, mbrojtësit të tij, avokat Hajrip Krasniqi, të pandehurve N.B, J.K, të pandehurit SO.B, mbrojtësit të tij, avokat Vigan Rugova,

pasi u këshillua dhe votoi më 31 janar 2013, në pajtim me nenin 392 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm “KPPK”), më 1 shkurt 2013 shpall publikisht dhe në prani të palëve këtë:

AKTGJYKIM

1. E.K, emri i babait, lindur më në (.....),,,,,, në paraburgim nga data 14.12.2010 deri më 2 gusht 2011,

SHPALLET JO FAJTOR

- sepse nuk u provua se më 17 dhe 18 korrik 1998, në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dhe në bashkëpunim me ushtarë të tjerë të UÇK-së deri më sot të paidentifikuar, zbatoi masat e frikësimit dhe terrorit kundër popullatës civile serbe të Opterushës duke marrë pjesë në një sulm të armatosur të qëllimtë kundër familjeve serbe të ndodhura në fshatin në fjalë.

Prandaj, në bazë të nenit 390 paragrafi 3 të KPPK-së, i pandehuri **E.K** lirohet nga akuza e **krimeve të luftës kundër popullatës civile**, në shkelje të neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë (KPRSFJ), tani vepër e dënueshme nga nenet 31 dhe 153 paragrafët (2.1) dhe (2.14) të KPRK-së, lidhur me Nenin 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të datës 12.08.1949, dhe nenin 13.2 të Protokollit II Shtesë të datës 08.06.1977, të Konventave të Gjenevës të vitit 1949 (Protokolli II Shtesë).

2. MU.H, emri i babait, emri i nënës, lindur më në,,,,,

SHPALLET JO FAJTOR

- sepse nuk u provua se ai ndihmoi E.Kn (nën hetim për veprën e krimit të luftës kundër popullatës civile, sepse në bashkë-kryerje me ushtarë të tjerë ende të paidentifikuar të UÇK-së, ai zbatoi masat e frikësimit dhe terrorit kundër popullatës civile serbe të fshatit Opterushë duke marrë pjesë në një sulm të armatosur të qëllimtë kundër familjeve serbe të ndodhura në fshatin në fjalë), për të shmangur zbulimin duke dhënë dëshmi të rreme në mbështetje të alibisë së mbrojtjes së E.Kt, më konkretisht, kur u

Prandaj, në bazë të nenit 390 paragrafi 3 të KPPK-së i pandehuri **N.H** lirohet nga akuza e **dhënies së ndihmës kryerësit pas kryerjes së veprës penale**, në shkelje të nenit 305 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës, tani vepër e dënueshme nga neni 388 (1) dhe (2) të KPRK-së.

5. N.B, emri i babait, emri i nënës, lindur më, në,,,,,

SHPALLET JO FAJTOR

- sepse nuk u provua se ai ndihmoi E.Kn (nën hetim për veprën e krimit të luftës kundër popullatës civile, sepse në bashkë-kryerje me ushtarë të tjerë ende të paidentifikuar të UÇK-së ai zbatoi masat e frikësimit dhe terrorit kundër popullatës civile serbe të Fshatit Opterushë duke marrë pjesë në një sulm të armatosur të qëllimtë kundër familjeve serbe të ndodhura në fshatin në fjalë) për të shmangur zbulimin duke dhënë dëshmi të rreme në mbështetje të alibisë së mbrojtjes së E.Kt, më konkretisht, kur u dëgjua në cilësinë e tij si dëshmitar nga oficerët e Njësisë së EULEX-it për Hetimin e Krimeve të Luftës në fshatin Rugovë më 3 mars 2011, ai deklaroi në mënyrë të rreme se E.K u plagos në fillim të korrikut 1998.

Prandaj, në bazë të nenit 390 paragrafi 3 të KPPK-së i pandehuri **N.B** lirohet nga akuza e **dhënies së ndihmës kryerësit pas kryerjes së veprës penale**, në shkelje të nenit 305 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës, tani vepër e dënueshme nga neni 388 (1) dhe (2) të KPRK-së.

6. J.K, emri i babait, emri i nënës, lindur më, në,,,,

SHPALLET JO FAJTOR

- sepse nuk u provua se ai ndihmoi E.Kn (nën hetim për veprën e krimit të luftës kundër popullatës civile, sepse në bashkë-kryerje me ushtarë të tjerë ende të paidentifikuar të UÇK-së, ai zbatoi masat e frikësimit dhe terrorit kundër popullatës civile serbe të Fshatit Opterushë duke marrë pjesë në një sulm të armatosur të qëllimtë kundër familjeve serbe të ndodhura në fshatin në fjalë), për të shmangur zbulimin duke dhënë dëshmi të rreme në mbështetje të alibisë së mbrojtjes së E.Kt, më konkretisht, kur u dëgjua në cilësinë e tij si dëshmitar nga oficerët e Njësisë së EULEX-it për Hetimin e Krimeve të Luftës in Prishtinë më 8 mars 2011, ai deklaroi në mënyrë të rreme se E.K u plagos në fillim të korrikut 1998.

Prandaj, në bazë të nenit 390 paragrafi 3 të KPPK-së i pandehuri **J.K** lirohet nga akuza e **dhënies së ndihmës kryerësit pas kryerjes së veprës penale**, në shkelje të nenit 305 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës, tani vepër e dënueshme nga neni 388 (1) dhe (2) të KPRK-së.

7. SO.B, emri i babait, lindur më në (.....),,,, në paraburgim që më 18 prill 2012,

SHPALLET JO FAJTOR

- sepse nuk u provua se më 17 dhe 18 korrik 1998, në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), në bashkëpunim me E.Kn dhe me ushtarë të tjerë të paidentifikuar të UÇK-së, zbatoi masat e frikësimit dhe terrorit kundër popullatës civile serbe të Optrushës duke marrë pjesë në një sulm të qëllimtë kundër familjeve serbe të ndodhura në fshatin në fjalë.

Prandaj, në bazë të nenit 390 paragrafi 3 të KPPK-së, i pandehuri **SO.B** lirohet nga akuza e **krimeve të luftës kundër popullatës civile**, në bazë të neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë (KPRSFJ), tani vepër e dënueshme nga Nenet 31 dhe 153 paragrafët (2.1) dhe (2.14) të KPRK-së, lidhur me Nenin 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të datës 12.08.1949, dhe nenin 13.2 të Protokollit II Shtesë të datës 08.06.1977, të Konventave të Gjenevës të vitit 1949 (Protokolli II Shtesë).

SHPENZIMET

Ne pajtim me nenin 103 të KPPK-së, këto shpenzimet të procedurës penale nën nenin 99 paragrafi 2 nënparagrafi 1 deri në 5 të KPPK-së, shpenzimet e domosdoshme të pandehurve duke përfshirë pagesën dhe shpenzimet të domosdoshme të avokatëve mbrojtës duhet të paguhet nga mjetet buxhetore.

ARSYETIM

I. Ecuria procedurale

Më 20.12.2007, Gjykata e Qarkut në Beograd hodhi poshtë akuzat ndaj S. M. për veprën penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile në Optrushë më 21.7.1998. Më 03.03.2009, Gjykata Supreme e Republikës së Serbisë e revokoi aktgjykimin dhe e ktheu lëndën në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

Më 19.8.2010, kreu i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) i dërgoi kërkesë Serbisë për një urdhër arresti dhe materiale provuese përkatëse në lëndën e S. M.

Më 20.8.2010, prokurori publik i PSRK-së shqiptoi aktvendim për fillimin e hetimeve ndaj S. M. për veprën penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile në Optrushë më ose rreth datës 18.7.1998.

Më 29.11.2010, zëvendës prokurori për krime të luftës i Republikës së Serbisë e informoi prokurorin publik të PSRK-së se, për shkak të rrethanave politike të njohura të tanishme, as ai, as proces-mbajtësi, as ndonjë personel tjetër i gjykatës nuk është në gjendje të vijë dhe të japë dëshmi në Kosovë në hetimin kundër S.M. në cilësi zyrtare.

Në datën 30.11.2010, prokurori publik i PSRK-së shqiptoi aktvendim për zgjerimin e hetimeve kundër E.Kt, SO.Bt dhe H.Mt për veprën penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile në Optrushë më ose rreth datës 18.7.1998.

Më 01.12.2010, prokurori publik i PSRK-së shqiptoi aktvendim për pushimin e hetimeve kundër S. M.

Më 14.12.2010, policët e Njësisë së Hetimit të Krimeve të Luftës (NJHKL) arrestuan E.Kn dhe H.Mn.

Më 14.12.2010, Gjyqtari i EULEX-it i procedurës paraprake në Gjykatën e Qarkut Prizren lëshoi aktvendim për paraburgim kundër E.Kt dhe H.Mt për një muaj, deri në 14.01.2011. Më 21.12.2010, kolegji prej tre gjyqtarësh i gjykatës së qarkut në Prizren i hodhi poshtë ankesat kundër aktvendimit.

Më 15.12.2010, Gjyqtari i EULEX-it i procedurës paraprake në Gjykatën e Qarkut Prizren, pasi kishte marrë një kërkesë për urdhër-arresti nga PSRK, shqiptoi urdhër-arrestin kundër SO.Bt.

Më 22.12.2010, Gjyqtari i EULEX-it i procedurës paraprake në Gjykatën e Qarkut Prizren, duke vendosur lidhur me kërkesën për lëshimin e letër-rreshtimit të brendshëm të paraqitur nga PSRK, shqiptoi urdhrin për lëshimin e letër-rreshtimit kundër SO.Bt.

Më 22.12.2010, Gjyqtari i EULEX-it i procedurës paraprake në Gjykatën e Qarkut Prizren, duke vendosur lidhur me kërkesën e PSRK-së për lëshimin e një letër-rreshtimi ndërkombëtar, paraqiti në Departamentin për Çështje Ligjore, Divizioni për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë, një kërkesë për lëshimin e letër-rreshtimit ndërkombëtar kundër SO.Bt.

Më 13.01.2011, kolegji prej tre gjyqtarësh i gjykatës së qarkut në Prizren shqiptoi aktvendim për vazhdimin e paraburgimit ndaj E.Kt dhe H.Mt për dy muaj, deri më 14.03.2011. Më 21.01.2011, Gjykata Supreme e Kosovës e hodhi poshtë ankesën e E.Kt kundër këtij aktvendimi.

Më 08.03.2011 prokurori publik i PSRK-së lëshoi një vendim në zgjerimin e hetimeve ndaj MU.Ht, MI.Ht, N.Ht, N. B. dhe J.Kt për veprën penale të dhënies së ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale.

Më 14.03.2011, Gjyqtari i EULEX-it i procedurës paraprake në Gjykatën e Qarkut Prizren mori aktvendim për vazhdimin e paraburgimit ndaj E.Kt dhe H.Mt për një muaj, deri më 14.04.2011.

Më 30.03.2011, prokurori publik i PSRK-së ngriti aktakuzën (PPS 75/2010) në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër E.Kt dhe H.Mt për këto vepra penale: 1) krime lufte kundër popullatës civile në Optrushë më 17. dhe 18.07.1998 dhe 2) krime lufte kundër popullatës civile në Optrushë më 18.07.1998; dhe kundër MU.Ht, MI.Ht, N.Ht, N. B.dhe J.Kt për veprën penale të dhënies së ndihmës kryerësve pas kryerjes e veprave penale.

Më 04.04.2011, kolegji prej tre gjyqtarësh i gjykatës së qarkut në Prizren lëshoi aktvendim për vazhdimin e paraburgimit ndaj E.Kt dhe H.Mt për dy muaj, deri më 04.06.2011.

Më 29.04.2011, gjykatësi i EULEX-it për konfirmimin e aktakuzës, pasi zhvilloi një seancë dëgjimore, e hodhi poshtë akuzën nr. 2 ndaj E.Kt dhe H.Mt, por konfirmoi akuzat e tjera. Më 09.06.2011, kolegji prej tre gjyqtarësh i Gjykatës së Qarkut të Prizrenit i hodhi poshtë ankesat e E.Kt, MU.Ht dhe MI.Ht kundër aktvendimit të konfirmimit.

Më 13.05.2011, prokurori publik i PSRK-së shqiptoi aktvendim për pezullimin e hetimeve kundër SO.Bt, me arsyetimin se vendndodhja e tij ishte e panjohur.

Më 02.06.2011, kolegji prej tre gjyqtarësh i gjykatës së qarkut në Prizren lëshoi një vendim për vazhdimin e paraburgimit ndaj E.Kt dhe H.Mt për dy muaj, deri në 08.04.2011.

Më 28.06.2011, filloi seanca e parë e shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Qarkut Prizren.

Më 02.08.2011, Gjykata e Qarkut në Prizren, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të hapur më 28, 29, 30 qershor, 7, 26 dhe 27 korrik 2011, shpalli aktgjykimin P. nr. 134/11, me të cilin i pandehuri E.K u gjet fajtor dhe dënua me pesë (5) vjet burgim, i pandehuri H.M u lirua nga akuza, të pandehurit MU.H, MI.H, N.H, N. B. dhe J.K u gjetën fajtorë dhe secili nga këta të pandehur u dënua me kusht me gjashtë (6) muaj burgim, me kusht që të mos kryejnë veprë tjetër penale brenda një periudhe prej një (1) viti.

Më 18.04.2012, prokurori publik i PSRK-së mori aktvendim për rifillimin e hetimeve kundër SO.Bt.

Më 18.04.2012, Gjyqtari i EULEX-it i procedurës paraprake në Gjykatën e Qarkut Prizren shqiptoi aktvendim duke urdhëruar paraburgimin kundër SO.Bt. I pandehuri SO.B u ekstradua

nga Shqipëria më 18 prill 2012 dhe në të njëjtën ditë u soll para gjyqtarit të procedurës paraprake.

Më 04.05.2012, Gjyqtari i EULEX-it i procedurës paraprake në Gjykatën e Qarkut Prizren duke vepruar lidhur me kërkesën për vazhdimin e hetimeve, shqiptoi aktvendim për vazhdimin e hetimeve kundër SO.Bt deri më 6 gusht 2012.

Më 16.05.2012, kolegji prej tre gjyqtarësh i Gjykatës së Qarkut në Prizren duke vendosur lidhur me kërkesën për vazhdimin e paraburgimit, dha aktvendim me të cilin e vazhdoi paraburgimin kundër të pandehurit SO.B për dy muaj të tjerë, deri më 18 korrik 2012.

Më 31.05.2012, PSRK paraqiti në Gjykatën e Qarkut Prizren Aktakuzën PPS. nr. 75/2010 kundër të pandehurit SO.B me veprat penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile, në shkelje të neneve 22 dhe 142 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme nga nenet 23 dhe 121 (1) të KPK-së, lidhur me nenin 3 të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12.08.1949 dhe nenin 13.2 të Protokollit II Shtesë të datës 08.06.1977, të Konventave të Gjenevës të vitit 1949 (Protokolli Shtesë II).

Më 07.06.2012, kolegji prej tre gjyqtarësh i Gjykatës së Qarkut në Prizren duke vendosur sipas detyrës zyrtare në pajtim me nenin 306 (5) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme “KPPK”) mori aktvendim për vazhdimin e paraburgimit ndaj SO.Bt deri më 07.08.2012.

Më 27.06.2012, gjyqtari konfirmues i EULEX-it në Gjykatën e Qarkut Prizren, pas një seance lidhur me konfirmimin e aktakuzës, shpalli aktvendimin KA 97/12, me të cilin konfirmoi aktakuzën e PSRK-së, PPS. nr. 75/2010, të datës 30.05.2012, kundër të pandehurit SO.B.

Më 06.08.2012, gjyqtari i EULEX-it i Gjykatës së Qarkut në Prizren, duke vepruar si kryetar i trupit gjykues, duke vendosur sipas detyrës zyrtare në pajtim me nenin 287 (2) të KPPK-së, shqiptoi aktvendim për vazhdimin e paraburgimit ndaj SO.Bt deri në 07.10.2012.

Më 04.09.2012, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur lidhur me ankesat e mbrojtësve të të pandehurve E.K dhe N.H, shqiptoi aktvendimin Ap-Kz 20/2012, me të cilin anuloi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. nr. 134/11, me përjashtim të pjesës që lidhet me lirimin nga akuza të H.Mt, e cila nuk ishte objekt i ankesës, dhe lëndën kundër të pandehurve E.K, N.H, MU.H, MI.H, N.B dhe J.K e ktheu në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim.

Më 04.10.2012, gjyqtarja e EULEX-it e Gjykatës së Qarkut në Prizren, duke vepruar si kryetare e trupit gjykues, duke vendosur sipas detyrës zyrtare në pajtim me nenin 287 (2) të KPPK-së, shqiptoi aktvendim për vazhdimin e paraburgimit ndaj S. B., deri në 07.12.2012.

Më 07.11.2012, trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut Prizren, duke vendosur lidhur me kërkesën e PSRK-së për bashkimin e procedurave penale, shqiptoi aktvendim me të cilin bashkoi

procedurën penale në lëndën penale kundër të pandehurve E.K, MU.H, MI.H, N.H, N. B., J.K, të akuzuar në bazë të Aktakuzës PPS. nr. 75/2010, dhe të procedurës penale në lëndën penale kundër të pandehurit SO.B, i akuzuar në bazë të Aktakuzës PPS. nr. 75/2010. Gjykata vendosi që kjo lëndë të udhëhiqej me numrin P. Nr. 249/12.

Më 30.11.2012 filloi shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën e Qarkut të Prizrenit.

Më 05.12.2012, Gjyqtarja e EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Prizren, duke vepruar si kryetare e trupit gjykues, duke vendosur sipas detyrës zyrtare në pajtim me nenin 287 (2) të KPPK-së, shqiptoi aktvendim për vazhdimin e paraburgimit ndaj SO.Bt, deri më 07.02.2013.

II. Kompetenca e gjykatës

Sipas nenit 23 pika 1 i) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm “KPPK”), gjykatat e qarkut gjykojnë lëndë penale që përfshijnë akuza për të cilat ligji lejon shqiptimin e dënimit penal prej së paku pesë vjet. Të pandehurit E.K dhe S. B. ishin akuzuar me veprën penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile, vepër e cila mbart një dënim minimal prej pesë vjetësh (sipas nenit 142 të KP të RSFJ-së).

Prandaj Gjykata e Qarkut është organi kompetent për të gjykuar këtë procedurë penale.

Sipas nenit 3.1 të Ligjit mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen dhe Ndarjen e Lëndëve tek Gjyqtarët dhe Prokurorët e EULEX-it (“Ligji mbi Juridiksionin”), Gjyqtarët e EULEX-it kanë juridiksion dhe kompetencë “mbi çdo lëndë të hetuar apo ndjekur penalisht nga PSRK”. Kjo lëndë është hetuar dhe ndjekur penalisht nga prokurorët e PSRK-së. Trupi gjykues përbëhej nga Gjyqtarja e EULEX-it, Mariola Pashnik, dhe gjyqtarët vendorë, gjyqtari Skënder Çoçaj dhe gjyqtarja Teuta Krusha, si anëtarë të trupit gjykues. Palët nuk patën kundërshtime lidhur me përbërjen e trupit gjykues.

Bashkimi i procedurave penale

Që kur Kodi i ri i Procedurës Penale hyri në fuqi më 01.01.2013, në bazë të nenit 545 paragrafi 1 të KPP-së, trupi gjykues, me aktvendimin e tij të datës 11 janar 2013, vendosi që procedura penale në lëndën P. nr. 249/12 kundër të pandehurve E.K, SO.B, MU.H, MI.H, N.H, N. B. dhe J.K, të vazhdohet në bazë të Kodit të Vjetër të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK).

III. Provat e administruara

A. Dëshmitarët

1. D.B(palë e dëmtuar)
2. S.B(palë e dëmtuar)
3. H.M
4. A.B
5. F.M
6. P.M
7. N.M
8. A.H

B. Provat me shkrim

Gjykata pranoi si prova e dëshmi këto dokumente që u lexuan ose u konsideruan si të lexuara gjatë shqyrtimit kryesor:

1. Dëshminë e dhënë nga D.B në shqyrtimin e parë më datë 28 dhe 29 qershor 2011.
2. Dëshminë e dhënë nga S.B në shqyrtimin e parë më datë 29 qershor 2011.
3. Dëshminë e dhënë nga A.B në shqyrtimin e parë më datë 30 qershor 2011.
4. Dëshminë e dhënë nga F.M në shqyrtimin e parë më datë 30 qershor.
5. Dëshminë e dhënë nga P.M në shqyrtimin e parë më datë 30 qershor 2011.
6. Dëshminë e dhënë nga N.M në shqyrtimin e parë më datë 30 qershor 2011.
7. Dëshminë e dhënë nga A.H datë 30 qershor 2011.
8. Kërkesën për anëtarësim në UÇK për SO.Bn.

C. Prokurori

Lista e dokumenteve të Paraqitura nga Akuza më 1 korrik 2011 dhe lista e dokumenteve të paraqitura nga Akuza më 25 janar 2013.

1. Procedura që tregonte foto të dëshmitares D.B 26.10.2010, faqja B 97/ B 137
2. Procedura që tregonte foto të dëshmitares S.B 27.10.2010, faqja B 138/B 170
3. Raport i policisë i datës 02.12.2010, faqja B 171/ B 185
4. Raport i policisë i datës 9.12.2010, faqja B 186/ B 196
5. Raport i policisë i datës 21.12.2010, faqja B 269/ B 270
6. Regjistri i paraqitur nga A. H. për NJHKL-në më 21.12.2010
7. Proces-verbal i deklaratës së dhënë nga dëshmitari J.K më 08.02.2011 dhe më 08.03.2011, faqja B1/B23
8. Proces-verbal i deklaratës së dhënë nga dëshmitari MU.H më 23.02.2011, faqja B 30 / B 39
9. Proces-verbal i deklaratës së dhënë nga dëshmitari MI.H më 23.02.2011, faqja B 65 / B 74
10. Proces-verbal i deklaratës së dhënë nga dëshmitari N.B më 03.03.2011, faqja B 47 / B 58
11. Proces-verbal i deklaratës së dhënë nga dëshmitari N.H më 03.03.2011, faqja B 81 / B 90

D. Dëgjimi i të pandehurve

1. E.K
2. MU.H
3. MI.H
4. N.H
5. N.B
6. J.K
7. SO.B

E. Gjykata pranoi si prova deklaratat e mëposhtme që u konsideruan si të lexuara gjatë shqyrtimit gjyqësor:

1. Deklaratën e E.Kt më 14.12.2010, 24.01.2011 dhe 07.07.2011
2. Deklaratën e MU.Ht më 23.02.2011, 14.03.2011 dhe 07.07.2011
3. Deklaratën e MI.Ht më 23.02.2011 dhe 14.03.2011 dhe 07.07.2011
4. Deklaratën e N.Ht më 03.03.2011, 17.03.2011 dhe 07.07.2011
5. Deklaratën e N. B. më 03.03.2011, 17.03.2011 dhe 07.07.2011
6. Deklaratën e J.Kt më 08.02.2011, 08.03.2011, 15.03.2011 dhe 07.07.2011
7. Deklaratën e SO.Bt më 18.04.2012.

IV. Përmbledhje e fakteve të pakontestuar

1. Se në natën e 17 korrikut dhe deri në orët e hershme të mëngjesit të 18 korrikut 1998, në fshatin Opterushë (qarku i Rahovecit) ndodhi një sulm i armatosur.
2. Sulmi u përqendrua drejt një shtëpie në pronësi të familjes së dëshmitares D. B., në të cilën në atë kohë ishin strehuar shumica e familjeve serbe që jetonin në fshat. Gjatë sulmit, meshkujt serbë iu përgjigjën zjarrit ndaj sulmuesve.

V. Fakte të kontestuar

1. I pandehuri E.K mohon të ketë qenë i pranishëm dhe të ketë marrë pjesë në sulmin më 17 dhe 18 korrik 1998 në Opterushë.
2. I pandehuri SO.B mohon të ketë qenë i pranishëm më 17 dhe 18 korrik 1998 në Opterushë, duke theksuar se ai ishte në fshatin Samadraxha tek daja i tij.
3. Në çfarë shkalle serbët ishin nën statusin e veçantë të civilëve, veçanërisht sepse burrat në atë shtëpi ishin të armatosur dhe bënë qëndresë gjatë sulmit.
4. Të pandehurit MU.H, MI.H, N.H, N.B dhe J.K mohojnë të kenë dhënë deklaratat të rreme kur u intervistuan nga hetuesit e EULEX-it lidhur me kohën kur u plagos i pandehuri E.K.

VI. Përmbledhje e gjendjes faktike të provuar

1. Më 17 dhe 18 korrik 1998, një grup të panjohurish sulmuan me armë zjarri shtëpinë civile të D.B dhe familjes së saj në fshatin Operushë nga anë të ndryshme. Të pranishëm në shtëpi gjatë sulmit ishin pothuajse të gjithë banorët serbë të fshatit, gjithsej rreth 15 persona.
2. Gjatë sulmit, meshkujt serbë iu përgjigjën zjarrit me pushkë dhe pistoleta.
3. Në mëngjesin e 18 korrikut 1998, familjet serbe hoqën dorë nga qëndresa e tyre dhe u dorëzuan. Menjëherë pas kësaj oborri i shtëpisë B. u mbush me njerëz të panjohur.
4. Ndër njerëzit që hynë në oborr ishin të pranishëm edhe të pandehurit E.K dhe SO.B.
5. Të pandehurit M.I.H, N.H, N.B, dhe J.K, kur u intervistuan si dëshmitarë, u dhanë hetuesve të gjithë deklaratat të rreme lidhur me datën kur u plagos i pandehuri E.K, me qëllim që t'i jepnin alibi mbrojtjes së K.

VII. Provat dhe dëshmitë lidhur me gjendjen faktike të provuar

Të përgjithshme

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, gjykata e gjen dëshminë e dëshmitareve dhe palëve të dëmtuara D.B dhe S. B. në përgjithësi të besueshme, për shkak se ato përshkruan ngjarjet në mënyrë të ngjashme në gjithë deklaratat e ndryshme që dhanë, dhe gjykata nuk gjen arsye përse ato duhet të gënjejnë. Rrjedhimisht gjykata vendos shumë rëndësi në këto dëshmi, në radhë të parë të dhëna në gjykatë më 28 dhe 29 qershor 2011, por të plotësuara nga deklaratat e tyre të mëparshme dhënë policisë/prokurorisë, me gjithë deklaratimet faktike të pasakta në disa pjesë të vogla, të cilat gjykata i konsideron normale, sidomos duke pasur parasysh se incidenti ka ndodhur 15 vjet më parë.

Prania e E.Kt dhe SO.Bt më 17 dhe 18 korrik 1998 në fshatin Operushë

Një ndër pikat kryesore faktike të shqyrtuara nga gjykata është nëse të pandehurit E.K dhe SO.B ishin të pranishëm në Fshatin Operushë gjatë sulmi më 17 dhe 18 korrik 1998 dhe nëse ata morën pjesë në sulmin kundër familjeve serbe.

Dëshmia e dëshmitares (dhe palë e dëmtuar) D.B

Në dëshminë e saj të 28 qershorit 2011, të dhënë në shqyrtimin e parë gjyqësor (proces-verbali nga faqja 13 e tutje), D.B përshkruan se rreth 15 serbë u mblodhën në shtëpinë e tyre, meshkuj dhe femra, të afërm dhe fqinjë. Me përjashtim të dy serbëve të tjerë, të gjithë serbët në Operushë u mblodhën në shtëpinë B. më 17 korrik 1998.

Në pyetjen e prokurorit publik: *Pse u mblodhën të gjithë në shtëpinë tuaj?*

D.B: Sepse ne nuk guxonim të shkonim gjëkund, sepse nga oborri ne i pamë ata duke kaluar pranë portës sonë, atëherë ne u mblodhën atje të gjithë bashkë Atë ditë

xhaxhai B. B. i la delet jashtë për kullotë në malin që është mbi fshatin tonë. Dhe ai u kthye në shtëpi kur filluan të shtënat.

Prokurori Publik: Thatë 'ne i pamë ata duke kaluar', cilët janë "ata"?

D.B: Nuk e di se kush ishin, ndoshta nga fshati.

D.B më tej deklaroi se më 17 korrik 1998, rreth 00:30 ose 01.00 pas mesnate, rryma u ndërpre. Pak pasi u ndal rryma, dikush thirri 'O D., mos dil', në gjuhën shqipe. Emri i tij ishte M., por shkurtimi ishte D., gjithkush e quante D.

Prokurori Publik: Pra, emri i bashkëshortit tuaj 'ishte M., por të gjithë e thërritnin D.?'

D.B.: Po, të gjithë, edhe ne në shtëpi ...

D.B: Mos dilni jashtë. Burri im menjëherë u drejtua për në korridor për të hapur derën dhe unë i thashë mos dil jashtë. Unë nuk e lashë të dilte jashtë dhe pas një kohë të shkurtër, do të thotë pas një a dy minutash, ata filluan të shtinë në shtëpinë tonë, në çati, në gjithë çatinë.

Prokurori Publik: A ishte kjo një e shtënë e vetme, rafallë të shtënash, apo, a mund t'i përshkruani këto shtëna?

D.B: Nuk ishte vetëm një e shtënë, unë nuk e di sa të shtëna pushkësh u qëlluan, por ka pasur të shtëna të forta.

Prokurori Publik: Tani, të kthehemi një hap prapa, kur dikush bërtiti 'mos dil jashtë', a e dini kush e tha këtë fjali?

D.B: Unë e pyeta burrin, kush po të thërret, ai tha: 'largohu tutje, po thërret 'J.', faqe 19 e procesverbalit të datës 28 qershor 2011.

Nga momenti që filluan të shtënat, ato zgjatën deri në mëngjes. Në deklaratën e saj te prokurori publik më 26 tetor 2010, dëshmitarja D.B deklaroi se meshkujt serbë në shtëpi kishin pushkë me vete dhe iu përgjigjën zjarrit pasi filluan të shtënat. Kjo u confirmua nga ana e saj gjatë shqyrtimit të parë gjyqësor. Më tej ajo deklaroi se, kur filluan të shtënat, burri i saj u tha grave të shkojnë dhe të strehohen në bodrum. Ato ndenjën në bodrum gjithë natën, kështu që nuk e dinin se çfarë po ndodhte. Pastaj, kur gjendja u qetësua pak në mëngjes, ajo doli nga bodrumi dhe papritmas oborri i tyre u mbush plot.

Dëshmitarja deklaroi më tej në gjykatë se ajo i njihte të pandehurit E.K dhe SO.B para sulmit të 17 korrikut, për shkak se ata ishin të gjithë pjesëtarë të të njëjtit fshati.

Pasi serbët u dorëzuan në mëngjesin e 18 korrikut 1998, D.B deklaroi se oborri i shtëpisë u

mbush me njerëz, disa prej të cilëve ishin në rroba civile, ushtarake, shumë-ngjyrëshe, rroba të zeza dhe të armatosur, me stemën e UÇK-së (faqe 22 e procesverbalit të datës 28 qershor 2011), E.K në mesin e tyre, të veshur në uniforma të zeza dhe të armatosur me pushkë (faqe 23 e procesverbalit të datës 28 qershor 2011). Megjithëse në dëshminë e saj në shqyrtimin gjyqësor më 28 qershor 2011 dëshmitarja ishte disi e paqartë nëse i pandehuri ishte i armatosur, pasi u mendua ajo konfirmoi atë që i kishte deklaruar prokurorit, se i pandehuri ishte i armatosur me pushkë kur ishte i pranishëm në oborr, menjëherë pas sulmit.

Kur u dëgjua si dëshmitare gjatë hetimit më 26 tetor 2010, D.B deklaroi se e pa SO.Bn në oborrin e shtëpisë së saj menjëherë pasi pushuan të shtënat më 18 korrik 1998.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 28 qershor 2011, ajo konfirmoi se njohu E.Kn dhe SO.Bn në mesin e njerëzve që hynë në oborr.

Në dëshminë e dhënë në rigjykim më 4 dhjetori 2012, D.B, në pyetjen e Prokurorit Publik nëse ajo pa SO.Bn duke hyrë në oborr së bashku me njerëzit e tjerë dhe nëse ajo kujton se çfarë lloj rrobash kishte veshur SO.B,

D.Bdeklaroi:

D.B: Me aq sa mund të mbaj mend, dhe mendoj se kam thënë të njëjtën gjë në deklaratën time, kam thënë se ai kishte rroba të gjelbra shumëngjyrëshe.

Prokurori Publik: Doni të thoni një lloj uniforme kamuflazhi?

D.B: Po.

Prokurori Publik: A mbante gjë në duar ose në trupin e tij?

D.B: Ata kishin pushkë. Unë nuk e di markën, por kishin pushkë me vete.

Prokurori Publik: A ju kujtohet nëse SO.B ishte i armatosur apo mbante armë?

D.B: Nuk e mbaj mend këtë. Unë kam dhënë deklaratat dhe ka kaluar kohë, kështu që nuk e mbaj mend tani. Siç thashë herën e fundit, po shikoja për djalin tim dhe e kam ende në sytë e mi se si iku. Nuk është e lehtë të duhej të shihja djalin tim dhe fshatarët e tjerë në atë situatë dhe t'u kushtoja vëmendje hollësive.

Gjykata i gjen deklaratat e dëshmitares D.B të besueshme sipas dijenisë së saj lidhur me identifikimin e të pandehurve E.K dhe SO.B dhe se ata ishin të dy të pranishëm në oborrin e shtëpisë së dëshmitares në mëngjesin e hershëm të 18 korrikut 1998, menjëherë pas pushimit të shkëmbimit të zjarrit.

Dëshmitarja D.B në deklaratat e saj përshkroi se të dy të pandehurit ishin të pranishëm në oborrin e shtëpisë në mëngjesin e hershëm të 18 korrikut 1998, të armatosur me pushkë dhe me uniforma shumëngjyrëshe, E.Kn mes tjerëve, të veshur në uniformë të zezë.

Megjithatë, prania e E.Kt dhe SO.Bt në oborin e shtëpisë B. menjëherë pasi kishte pushuar shkëmbimi i zjarrit, nuk jep prova të mjaftueshme për gjykatën se ata morën pjesë në sulmin e ndërmarrë ndaj shtëpive dhe familjeve serbe në Oplotushë më 17 korrik dhe në orët e hershme të mëngjesit të 18 korrikut 1998.

Dëshmitarja D.Bdeklaroi se gjatë sulmit ndërmjet netëve të 17 dhe 18 korrikut 1998, ajo dhe femrat e tjera serbe u strehuan në bodrumin e shtëpisë, ku qëndruan deri në mëngjesin e 18 korrikut 1998. Si rezultat, në deklaratat e saj dëshmitarja D.Bnuk qe në gjendje t'i japë gjykatës ndonjë provë se kush i sulmoi ata saktësisht.

Përveç kësaj, deklarata e dëshmitares D.Bse burri i saj dëgjoji zërin e "J." në natën e 17 korrikut dhe se ajo e paralajmëroi burrin e saj të mos dilte jashtë, pak para se të shtënat të fillonin, nuk jep prova të mjaftueshme për gjykatën se zëri që ajo dëgjoji ishte zëri i E.Kt, apo edhe nëse ajo ishte e saktë lidhur me këtë, prandaj gjykata nuk mund ta gjejë si të provuar se E.K mori pjesë në sulmin e ndërmarrë ndaj shtëpive dhe familjeve serbe në Oplotushë ndërmjet 17 dhe 18 korrikut 1998, për shkak se, siç u tha më lart, gjatë sulmit dëshmitarja ishte tërë natën e strehuar në bodrumin e shtëpisë, prandaj ajo nuk ishte në gjendje të jepte ndonjë provë në gjykatë se kush mori pjesë në këtë sulm.

Dëshmia e dëshmitares S. B.

Ajo dëshmoi para prokurorit publik më 27 tetor 2010 dhe dëshmia e saj në shqyrtimin gjyqësor të hapur duhet të vlerësohet me shpjegimin e saj të mëparshëm në prokurori. Është e kuptueshme që jo të gjitha detajet janë të pranishme në mënyrë të qartë në lidhje me një incident që ka ndodhur. Përveç kësaj, gjendja e saj fizike e tanishme, si pasojë e një goditjeje në tru, ka cenuar kujtesën e saj në lidhje me detajet e sakta.

Megjithatë, në dëshminë e saj të dhënë në shqyrtimin e parë gjyqësor, S. B. vërtetoi, ashtu si D.B, se gjatë sulmit të gjithë serbët në fshat u mblodhën në shtëpinë B.; se shtënat filluan në orën 6 pasdite të datës 17 korrik 1998 dhe zgjatën gjithë natën. Në pyetjen e prokurorit publik nëse ajo mban mend se në çfarë ore ndaluan të shtënat, përgjigja e S. B. ishte: *Nuk e mbaj mend, sepse po flinim në bodrum.* Ajo shpjegoi se në mëngjes shumë njerëz kishin mbushur oborin dhe i dërguan serbët në qendër të oborrit në një grup.

Prokurori Publik: Thatë se ata na vunë, kush ishin "ata"?

S.B: Ata ishin shumë njerëz, ne nuk i njihnim, disa ishin nga fshati ynë, disa jo.

Prokurori Publik: A kishin veshur uniforma?

S.B: Po.

Prokurori Publik: A ishin të armatosur?

S. B.: Po.

Prokurori Publik: A ju kujtohet të keni parë ndonjë emblemë mbi uniformat e tyre?

S.B: Jo, nuk i shikonim nga frika; ato ishin vetëm uniforma të gjelbra dhe të zeza.

Prokurori Publik: Para prokurorit publik, në lidhje me këtë, keni thënë se ata kishin emblema të UÇK-së mbi supe, disa kishin një shirit i zi në krah. A ju kujtohet kjo?

S.B: Po, por unë nuk dëgjoj mirë, kjo është arsyeja pse nuk mund ta shpjegoj.

Prokurori Publik: Në mes të ushtarëve ose njerëzve në uniformë që kishin hyrë në oborr, a njohët njeri?

S. B.: A e keni fjalën për njerëzit nga fshati ynë?

Prokurori Publik: Nga kudo, njerëzit që ju njohët dhe mundët të identifikoni?

S.B: Vetëm ata nga fshati ynë.

Prokurori Publik: Dhe a mund të na tregoni cilët njohët?

S.B: Njoha shumë njerëz, por nuk ua dija emrat, njoha djalin i cili ishte këtu, dhe SO.Bn.

Prokurori Publik: Njeri tjetër?

S.B: Ua dija emrat, por i kam harruar.

Prokurori Publik: Para prokurorit publik, për të njëjtin rast keni thënë, ndër të tjera, që nuk po i përmend për shkak se nuk janë relevante për këtë shqyrtim. Ju keni thënë, më kujtohet njëri, J. A ju kujtohet?

S.B: Po.

Prokurori Publik: A ju kujtohet ta keni parë atë në oborr?

S.B: Po.

Gjatë hetimeve më 27 tetor 2010 dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor më 29 qershor 2011, dëshmitarja S.B deklaroi se, sapo doli nga shtëpia B. në mëngjesin e 18 korrikut 1998, ajo pa SO.Bn në mesin e njerëzve të tjerë, të cilët ishin në oborrin e shtëpisë. Dëshmitarja ka një arsye për ta kujtuar SO.Bn me saktësi, sepse i ati i SO.Bt, M., kishte blerë disa toka nga dëshmitari.

Kur u pyet nga prokurori në shqyrtimin gjyqësor më 4 dhjetor 2012, S.B deklaroi se, në mëngjesin e 18 korrikut, menjëherë pas sulmit, ajo pa njerëz në oborr; ajo kishte njohur SO.Bn, i cili ishte i veshur me uniformë të gjelbër dhe mbante pushkë.

Gjykata i gjen të besueshme deklaratat e dëshmitares S.B lidhur me dijeninë dhe identifikimin prej saj të të pandehurve E.K dhe SO.B dhe se ata të dy ishin të pranishëm në oborrin e shtëpisë së dëshmitares D.Bnë mëngjesin e hershëm të 18 korrikut 1998.

Në deklaratat e saj Dëshmitarja S.B i përshkroi të dy të pandehurit si të pranishëm në oborr në mëngjesin e hershëm të 18 korrikut 1998.

Megjithatë, prania e E.Kt dhe SO.Bt në oborrin e shtëpisë B. menjëherë pasi ishte ndërprerë shkëmbimi i zjarrit, për gjykatën nuk përbën provë të mjaftueshme se ata morën pjesë në sulmin e ndërmarrë ndaj shtëpive dhe familjeve serbe në Opterushë ndërmjet 17 dhe 18 korrikut 1998.

Dëshmitarja S.B deklaroi se gjatë sulmit në mes të natës së 17 dhe 18 korrikut 1998, ajo dhe femrat e tjera serbe ishin të strehuar në bodrumin e shtëpisë, dhe deklaroi se ato po flinin në bodrum. Ato qëndruan aty deri në mëngjesin e 18 korrikut 1998, prandaj dëshmitarja nuk dha ndonjë dëshmi në gjykatë se kush i sulmoi ato gjatë natës së 17 dhe 18 korrikut 1998.

Identifikimi me anë të fotove

Në lidhje me dëshminë e saj në prokurori, dëshmitaret D.B dhe S.B identifikuan “J.” në një foto-rreshtim, edhe pse kjo e fundit me disa vështirësi.

Dëshmitarja D.B identifikoi dy të pandehurit E.K dhe SO.B në foto-identifikimin e zhvilluar më 26 tetor 2010.

Gjykata e gjen të vërtetuar në mënyrë të mjaftueshme se dëshmitarja D.Bi njohte të pandehurit E. “J.” K. dhe SO.B para sulmit dhe në këto kushte mundi t’i identifikojë.

Gjatë foto-identifikimit në 27 tetor 2010, Dëshmitarja S.B i njohu të pandehurit E.K dhe SO.B.

Në konstatimin përfundimtar të rrethanave të provuara, gjykata e vlerëson foto-identifikimin si provë relevante.

Të pandehurit E.K dhe SO.B

Të dy të pandehurit e mohuan në gjykatë të kenë marrë pjesë në sulmin e natës së 17 korrikut, dhe në orët e hershme të mëngjesit të 18 korrikut 1998.

E.K

E.K e ka mohuar pjesëmarrjen e tij në sulmin e 17 dhe 18 korrikut 1998, pasi ishte plagosur në betejë më 11 korrik 1998 dhe kishte qëndruar 15 ditë në spital.

Në deklaratën e tij në prokurori më 14 dhjetor 2010, së cilës i qëndroi në shqyrtimin e parë

gjqësor, ai deklaroi se ishte anëtar i UÇK-së dhe ishte kyçur në të në vitin 1998, në Drenicë. Ai kishte marrë postin e komandantit të kompanisë në fund të nëntorit 1998 dhe mohon ta ketë pasur këtë gradë në korrik 1998. Edhe pse është nga Opterusha, ai mohon ta ketë pasur bazën e UÇK-së në Opterushë, por se ka qenë në grupin e UÇK-së në Drenovc. Më tej ai thekson se nuk ka dijeni në lidhje me këtë sulm në Opterushë nga fundi i korrikut.

E.K deklaroi në prokurori më 14 dhjetor 2010, dhe qëndroi pranë kësaj në gjykatë gjatë shqyrtimit gjyqësor më 7 korrik 2011, se ai ishte “plagosur më 11 korrik 1998 në rrugën kryesore Gjakovë-Prizren, në afërsi të një fshati të quajtur Rugovë e Hasit, Komuna e Gjakovës”.

Prokurori Publik: Si ndodhi?

E.K: U zhvillua një luftim që zgjati 10-15 minuta. Ishim vetëm dy vetë, J. K., i cili voziste, dhe unë. Ishim në një Golf të bardhë I ose II, automjet civil, dhe hasëm në një xhip të blinduar. Ata ishin policë dhe ushtarakë me uniforma. Unë hapa zjarr kundër tyre me AK-47 timin nga një distancë prej 10 metrash. Makina jonë ishte në lëvizje ndërkohë që gjuaja. Shoku im nuk qëlloi. Unë qëllova nga dritarja; u mbështeta jashtë dritares së veturës dhe hapa zjarr. Atje ka dy ura në distancë 150 metra. Ne lëvizëm prapsh gjatë atyre 150 metrave, deri në kryqëzimin në fshatin Rugovë. Pas një shkëmbimi të madh zjarri me njerëzit në xhip, ne ramë nën zjarr edhe nga prapa. Një plumb e goditi veturën tonë dhe më goditi mua në shpinë. Kur u plagosa, makina ishte ende në lëvizje prapa. Plumbi hyrë nga dera e pasme në anën e shoferit, goditi ulësen e pasme, ulësen e përparme dhe më goditi mua. Nuk munda të shoh kush më qëlloi...

....

Prokurori Publik: A ishit në spital?

E.K: Mora ndihmën e parë nga një mjek në Rugovë të Hasit. Nuk e mbaj mend emrin e tij, por ai vdiq disa kohë më parë. Më mjekuan në shtëpinë e një farë S. G.. Ai jeton ende në Rugovë. Disa orë më vonë, shkova në spitalin në Gajrak. Ky është një fshat në afërsi të Pagarushës. Atje ishte një spital ushtarak i UÇK-së. Atje, një mjek i quajtur A.H ma mjekoi dhe lidhi plagën. Tani ai punon në spitalin e Prizrenit ... Në spital qëndrova 15 ditë. Nuk e mbaj mend datën, por në një moment spitali u zhvendos për shkak se po vinte një mësymje e serbëve. Atëherë unë shkova në shtëpinë e familjes së axhës tim në fshatin Randobravë atje qëndrova 8 ditë. Një mjek nga Krusha e Madhe ... vinte çdo ditë në shtëpinë e axhës tim për të më mjekuar plagën...

.....

Prokurori Publik: Të kthehemi në historinë e Opterushës, a keni dëgjuar në lidhje me një sulm që është kryer nga UÇK në atë fshat?

E.K: Jo.

Prokurori Publik: Pra, po më thoni se, megjithëse jeni nga Opterusha, ju nuk keni dëgjuar për një sulm që ka ndodhur atje?

E.K: E saktë.

Prokurori Publik: Pra, sipas asaj që po thoni, në Opterushë duhet të ketë ende serbë që jetojnë?

E.K: Nuk e di.

Prokurori Publik: Por, a e dini nëse ata janë ende atje?

E.K: Ata nuk janë më atje, por nuk e di pse.

.....

Prokurori Publik: Kur u plagosët, a kishit veshur uniformë?

E.K: Po.

Prokurori Publik: Çfarë ngjyre?

E.K: E zezë.

Prokurori Publik: A ka ndonjë rëndësi kjo ngjyrë?

E.K: Jo, uniformën e kisha blerë vetë, në të vërtetë. Ne kishim vetëm emblemat e UÇK-së. Me fjalë të tjera, ishte zgjedhja ime që të kisha uniformë të zezë, sepse më pëlqen kjo ngjyrë

Prokurori Publik: A njihni njeri me emrin B. nga Opterusha?

E.K: Po.

Prokurori Publik: A kishte ndonjë B. nga Opterusha me UÇK-në?

E.K: Jo

Prokurori Publik: Përveç jush, a ishte dikush nga Opterusha anëtar i UÇK-së?

E.K: S. B. ishte ndër të parët që u kyç dhe ai ishte gjithë kohën me mua. Gjithashtu.

Prokurori Publik: A janë ata gjallë?

E.K: Jo, të dy vdiqën.

Prokurori Publik: Pra, ju njihni vetëm këto të dy, të cilët tani janë të vdekur?

E.K: Njoh të tjerë, por ata nuk ishin me mua.

Prokurori Publik: Më tregoni emrin e ndokujt nga Opterusha i cili ishte ushtar i UÇK-së nga Opterusha në korrik 1998.

E.K: Nuk njoh njeri tjetër.

Prokurori Publik: Mendova se thatë se kur ishit në Drenovc të Zadriqit, kishte dhe ushtarë të tjerë nga Opterusha. A nuk është kjo e saktë?

E.K: Është e vërtetë, por nuk i dija emrat e tyre, pasi ata ishin të rinj. Përveç kësaj, unë kam jetuar larg Opterushës për disa kohë, isha në Zvicër për 5 vjet dhe në Prishtinë, kështu që u shkëputa nga jeta e fshatit.”

Në dëshminë e dhënë në shqyrtimin gjyqësor më 28 janar 2013, E.K deklaroi se ai qëndron pranë deklaratave të dhëna para prokurorit më 14 dhjetor 2010 dhe 24 dhjetor 2010, dhe deklaratave para gjykatës gjatë shqyrtimit të parë gjyqësor të datës 7 korrik 2011.

Siç e sheh gjykata, ka shumë pak të ngjarë që E.K të mos dinte rreth sulmit në Opterushë. Gjatë shqyrtimit të parë gjyqësor, E.K deklaroi disa herë se ishte krenar për përfshirjen e tij në UÇK dhe në luftën për lirinë e pavarësinë e Kosovës.

Në këto rrethana, gjykata i gjen deklaratat e E.Kt me besueshmëri të dyshimtë.

Gjykata e gjen të provuar se E.K ishte i pranishëm në oborrin e shtëpisë B. menjëherë pas ndërprerjes së shkëmbimit të zjarrit. Por prania e E.Kt në oborrin e shtëpisë së dëshmitares D.B menjëherë pas ndërprerjes së shkëmbimit të zjarrit nuk përbën provë të mjaftueshme për gjykatën se pandehuri E.K mori pjesë në sulmin gjatë natës së 17 dhe 18 korrikut 1998.

Kur shqyrton deklaratat e besueshme të dëshmitareve D.B dhe S.B dhe i sheh në lidhje me deklaratat e të pandehurve të tjerë, gjykata i gjen jo të besueshme deklaratat e dhëna nga i pandehurit E.K.

SO.B

Në dëshminë e dhënë para prokurorit publik më 18 prill 2012, SO.B deklaroi se u kyç UÇK më 27 tetor 1998. Ai e njihte E.Kn para luftës si pamje dhe emër, por nuk kishte lidhje me të.

E.K ishte shok i vëllait të tij. Vëllai i SO.Bt ishte me E.Kn në luftë që nga fillimi. Kur S. u kyç në UÇK, ai kishte marrëdhënie me E.Kn. Në fillim SO.B u stacionua në njësinë në fshatin Reti, nën komandën e Xhe. Ha.. Më vonë gjatë luftës ai qëndroi me E. dhe vëllain e tij. SO.B deklaroi se fillimisht komandantë ishin vëllai i tij dhe E., por pasi E. u plagos, vëllai i tij u bë udhëheqës i vetëm. Ai u kyç në UÇK në tetor 1998.

SO.B deklaroi se në fund të qershorit ose në fillim të korrikut 1998, kur granata e parë ra në fshat, ai e largoi familjen e tij të zgjeruar dhe shkoi në fshatin Samadraxhë, ku qëndroi për katër muajt e ardhshëm në shtëpinë e axhës së tij M. B.. Ai u kthye në Opterushë vetëm pas katër muajsh dhe më pas u kyç në UÇK. Kur u kthye në Opterushë, gjithë fshati ishte djegur nga forcat serbe, dhe atje ishte vetëm UÇK. Nuk kishte fare popullatë civile.

Në dëshminë e dhënë në shqyrtimin gjyqësor më 28 janar 2013, SO.B deklaroi se qëndron pranë deklaratës së dhënë në prokurori më 18 prill 2012.

Gjatë seancës së 28 janarit 2013, gjykata e pranoi si provë kërkesën e mbrojtësit të SO.Bt që tregon se i pandehuri SO.B ishte anëtar i UÇK-së që nga 27 tetori 1998.

Në këto rrethana, gjykata i gjen deklaratat e tij me besueshmëri të dyshimtë.

Kur shqyrton deklaratat e besueshme të dëshmitareve D.B dhe S.B dhe i sheh në lidhje me deklaratat e të pandehurve të tjerë, gjykata i gjen jo të besueshme deklaratat e dhëna nga i pandehurit SO.B.

Gjykata e gjen të provuar se SO.B ishte i pranishëm në oborrin e shtëpisë B. në mëngjesin e 18 korrikut 1998 menjëherë pas ndërprerjes së shkëmbimit të zjarrit. Por prania e SO.Bt në oborrin e shtëpisë së dëshmitares D.B në mëngjesin e 18 korrikut 1998 menjëherë pas ndërprerjes së shkëmbimit të zjarrit nuk provon se ai mori pjesë në sulmin kundër familjeve serbe gjatë natës midis 17 dhe 18 korrikut 1998.

Të pandehurit MU.H, MI.H, N.H, N.B dhe J.K dëshmuar të gjithë në mbështetje të faktit se E.K u plagos para se të ndodhte sulmi në Oplotushë.

I pandehuri MU.H, kur dha deklaratën e tij si dëshmitar në prokurori në fshatin Rogovë më 23 shkurt 2011, deklaroi se nuk ka dëgjuar për sulmin mbi serbët në fshatin Oplotushë në vitin 1998. Gjithashtu, ai është i afërm i të pandehurit E.K.

Kur u pyet në lidhje me kohën që E.K ishte i plagosur, deklarata e nënshkruar ka këtë përmbajtje :

...

Hetuesi: Kur ndodhi kjo?

Dëshmitari: Mendoj se ndodhi ditën. Ishte para vaktit të drekës.

Hetuesi: A është kjo në 1998?

Dëshmitari: Ishte vera e 98-ës.

Hetuesi: A ishte qershor, korrik, gusht apo shtator?

Dëshmitari: Mendoj se ishte korrik?

Hetuesi: Pse mendoni se ishte korrik?

Dëshmitari: Arsyeja kryesore që e mbaj mend kohën është se në atë kohë korrnim grurin. Ishte koha e saktë rreth 10 korrikut.

Hetuesi: A mund të shpjegoni pse plaga e E.Kt ka të bëjë me korrjen e grurit?

Dëshmitari: Sepse ishte koha e korrjes së grurit, që është në mes të 10 korrikut dhe 10 gushtit. Dhe kjo ndodhi në fillim të këtij sezoni dhe jo në gusht. Mbaj mend se ka pasur shumë njerëz përreth shtëpisë sime në atë kohë, sepse ishte koha për të korrur grurin.

...”

Më 14 mars 2011, ai dha deklaratë si i pandehur në hetuesi. Pastaj ai e konfirmoi deklaratën e tij më 23 shkurt 2011 në mënyrën e mëposhtme:

“PNH: A i konfirmoni ato që keni deklaruar në tërësi?”

MH: Po. Por dua të bëj vetëm një ndryshim, sepse nuk e di ditën e saktë, sepse ka kaluar kohë e gjatë. E di se ishte korrik, sepse po korrnim të lashtat. Nga fillimi dhe deri në mes të korrikut.”

Kjo deklaratë e dhënë në prokurori u konfirmua në gjykatë gjatë shqyrtimit të parë gjyqësor dhe më pas në rishqyrtim.

Gjykata e gjen tepër pa gjasa se i pandehuri nuk ka dëgjuar për sulmin mbi serbët në Oplotushë në korrik 1998, dhe e kupton padijeninë e deklaruar prej tij si mënyrë për të mbrojtur trashëgiminë e UÇK-së dhe luftën e drejtë për liri.

Duke qenë se ai është i afërm i të pandehurit E.K, gjykata e sheh më tej deklaratën e tij si të personit që përpiqet të mbrojë të afërmin e tij.

Megjithëse nuk është i sigurt për datën e saktë, prapëseprapë i pandehuri është i sigurt se E.K u plagos përpara mesit të korrikut, me fjalë të tjera përpara sulmit, sepse kjo ishte në fillim të sezonit të korrjes së grurit. Megjithatë, kjo është një ngjarje që ndodh çdo vit, dhe gjykata e gjen pa gjasa që ai mund ta mbante mend se kur gjatë sezonit të korrjes së vitit 1998 ndodhi plagosja.

Në përfundim, gjykata e gjen jo të besueshme deklaratën e tij lidhur me kohën e lëndimit të E.Kt.

Duke marrë parasysh sa vijon, ndikimin e të gjitha dëshmive të dhëna, deklaratat e MU.Ht në hetuesi lidhur me kohën kur u plagos E.K janë gjetur të provuara përtej dyshimit të arsyeshëm si të rreme.

I pandehuri MI.H dha deklaratë si dëshmitar para hetuesit të EULEX-it në fshatin Rogovë më 23 shkurt 2011, dhe deklaroi se E.K është daja i tij, por deklarata e tij u dha vullnetarisht. Ai është edhe vëllai i të pandehurit MU.H. Më tej ai deklaroi se nuk e dinte nëse E.K ka qenë pjesëtar i UÇK-së kur u plagos, pasi kjo ka ndodhur shumë kohë më parë. Ai ndihmoi për ta transportuar dajën e tij kur u plagos.

“Hetuesi: Kur ndodhi kjo?”

Dëshmitari: Siç i kemi punët tona, më 7 korrik 1998 pati ndërprerje të rrymës. Kompania elektrike na tha se ata nuk do ta kycin rrymën nëse nuk paguajnë para 11 korrikut dhe ne mblodhëm të hollat.

“E. u plagos më 11 korrik 1998. Jam i garantuar për këtë. E mbaj mend ditën, sepse

në atë ditë duhej t'i dorëzoja të hollat kolektorit të kompanisë elektrike. Pastaj shoku im i dha të hollat kolektorit. Atë natë, 11 korrik, patëm rrymë.”

Më 14 mars 2011, MI.H e konfirmoi deklaratën e tij të dhënë si dëshmi para hetuesit të EULEX-it dhe këtë ai e konfirmoi në gjykatë gjatë shqyrtimit të parë gjyqësor, duke e konfirmuar deklaratën e tij edhe në rigjykim.

Duke pasur parasysh se i pandehuri E.K është daja i tij, gjykata e gjen të kuptueshme se ai dëshiron të mbrojë dajën e tij.

Arsyen e deklaruar pse e mbante mend kohën kur daja i tij E.K ishte plagosur, gjykata e gjen tepër të pazakontë dhe kësisoj jo të besueshme.

Kur vlerëson të gjitha provat, siç ceket më lart dhe në vijim, gjykata i gjen të rreme deklaratat e MI.Ht dhënë në prokurori më 23 shkurt të vitit 2011 në fshatin Rugovë, lidhur me kohën kur u plagos E.K.

I pandehuri N.H, kur dha deklaratën e tij si dëshmitar në fshatin Rogovë më 3 mars 2011, deklaroi se ka dëgjuar thashethemet lidhur me sulmin mbi shtëpitë e civilëve serbë në korrik 1998 në Opterushë dhe se ai ishte pjesëtar i UÇK-së, por jo nën komandën e E.Kt. Ai deklaroi se ndihmoi në transportimin e të plagosurit E.K për në shkollën e Radobravës, ku e lanë.

Hetuesi: Kur ka ndodhur kjo?

Dëshmitari: Ditëlindja ime është më 11 qershor dhe kjo ndodhi më 11 korrik. Jam i sigurt për këtë. Mbaj mend që kam biseduar me njerëzit atje dhe u thashë se kjo ka qenë vetëm një muaj më parë. Kisha ditëlindjen time dhe tani kjo.

Hetuesi: A ka pasur ndonjë gjë tjetër të veçantë që ka ndodhur gjatë 11 korrikut 1998, që ju do ta mbanit mend?

Dëshmitari: Atë natë ne ruanim jashtë shtëpisë sime dhe atje diskutova se çfarë kishte ndodhur.

Hetuesi: A kishte rrymë gjatë 11 korrikut 1998 apo jo?

Dëshmitari: Është e vështirë të them, sepse kisha nevojë për rrymë.

Hetuesi: Kë takuat në shkollë në Radobravë?

Dëshmitari: Nuk e di, sepse ne vetëm sa e lamë atje dhe u kthyem përsëri këtu.

Si pandehur, ai konfirmoi deklaratat e tij më 17 mars 2011, dhe këtë ai e konfirmoi edhe në gjykatë gjatë shqyrtimit të parë gjyqësor. Deklaratën e tij e konfirmoi edhe në rigjykim.

Gjykata i gjen deklaratat e mësipërme tepër të pazakonta dhe të dyshimta lidhur me atë se pse ai e mbante mend datën e saktë kur u plagos E.K. Kur vlerëson të gjitha dëshmitë e dhëna,

gjkata gjen përtej dyshimit të arsyeshëm se deklarata e tij para hetuesit të EULEX-it më 3 mars 2011 në fshatin Rugovë, lidhur me kohën kur u plagos E.K, është e rreme.

I pandehuri N.B, kur dha deklaratën e tij si dëshmitar para prokurorit më 3 mars 2011 në Rogovë, deklaroi se ishte anëtar i UÇK-së nga prilli 1998 dhe se u takua me të pandehurin E.K kur ky i fundit u plagos, por pas luftës ai është takuar me E.Kn më shpesh. Kur u pyet në lidhje me kohën kur u plagos E.K, deklaratat e dhëna përmbajnë sa vijon:

“Hetuesi: Kur ndodhi që E.K u plagos dhe ju e ndihmuat?

Dëshmitari: Ishte java e parë e korrikut 1998. Ishte 10 ose 11 korrik.

Hetuesi: Si ka mundësi që data ju kujtohet saktësisht?

Dëshmitari: E mbaj mend, sepse Rahoveci u sulmua nga forcat serbe. Ai sulm ishte më 18 ose 17 korrik 1998. Mbaj mend që E. ishte plagosur rreth 1 javë para 18 ose 17 korrikut.

Hetuesi: Sa i sigurt jeni në lidhje me këtë?

Dëshmitari: Jam 100% i sigurt, sepse u plagos 2 ose 3 ditë më vonë se u plagos E.K.

Hetuesi: A është regjistruar në ndonjë mënyrë që ju u plagosët?

Dëshmitari: Kjo ishte në rrethana të vështira, kështu që nuk mendoj se u bë ndonjë regjistrim. Gjithsesi unë u mjekova nga mjekët vetëm 2-3 javë pasi isha plagosur.

Hetuesi: A e dini se duhet të tregoni të vërtetën? Përndryshe mund të akuzoheni. A jeni ende i sigurt në lidhje me datën?

Dëshmitari: Po, jam. Nuk gënjej. Kam mbajtur ditar.

Hetuesi: A mund ta shoh ditarin, ju lutem?

Dëshmitari: Jo, nuk e kam.

Hetuesi: Ku është ditarin?

Dëshmitari: E mbaja ditarin në shtëpi dhe shtëpia u dogj nga serbët. Ndodhi në prill 1999.

Hetuesi: A u përfshi E.K në luftimet në Opterushë?

Dëshmitari: Nuk e di.

....”

Më 17 mars 2011, N.B u mor në pyetje si i pandehur dhe konfirmoi deklaratat e tij të dhëna si dëshmitar. Ai i konfirmoi deklaratat e tij në gjykatë gjatë shqyrtimit të parë gjyqësor, si dhe në rigjykim.

Gjykata nënvizon se i pandehuri ishte ushtar i UÇK-së dhe kuptohet se donte të mbronte

trashëgiminë e UÇK-së dhe E.Kn të cilin ai e takoi fillimisht kur u plagos “J.” dhe që nga ajo kohë e ka takuar më shpesh. Sic e sheh gjykata, kjo zvogëlon besueshmërinë e deklaratave. Përveç kësaj, gjykata e gjen disi të pazakontë që ai mban mend vetëm kohën e lëndimit të E.Kt, kur ai është më se i pasigurt kur iu kërkua të jepte datat.

Duke marrë parasysh të gjitha provat, gjykata e gjen të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se deklaratat e dhëna nga N.B para prokurorit të EULEX-it më 3 mars 2011 në Rogovë lidhur me kohën kur u plagos E.K janë të rreme.

I pandehuri J.K, kur dha deklaratën e tij në prokurori si dëshmitar më 8 shkurt 2011 në Prishtinë, pranon se ka marrëdhënie shumë të mira me të pandehurin E.Kt dhe se nuk pajtohet që dikush sulmoi shtëpitë e serbëve në korrik të vitit 1998 në Opterushë. Ai gjithashtu deklaroi se ishte anëtar i UÇK-së që nga maji ose qershori 1998 dhe ishte një lloj udhëheqësi dhe se E.K vepronte në fshatin e tij, që ishte Opterushë, dhe se ai ishte përfshirë në një betejë së bashku me E.Kn kundër forcave serbe në fshatin Rogovë, dhe ishte me E.Kn kur ai ishte plagosur dhe më vonë e kishin çuar E.Kn e plagosur në spitalin e UÇK-së në Garjak, në zonën e Suharekës

Për më tepër, në hetuesi ai deklaroi ndër të tjera sa vijon:

... Unë kam vështirësi me emrat dhe datat. Por kjo ndodhi në fund të korrikut ose fillim të gushtit. Kur ata filluan të luftojnë kundër njëri-tjetrit ishte të paktën 20-25 ditë pasi E. u plagos.

Hetuesi: Kur e patë E. përsëri?

Dëshmitari: Mendoj se e pashë përreth Randubravës rreth 10 ditë më pas. Kisha dëgjuar se ai ishte zhvendosur nga fshati Garjak për në Rundubrave.

Hetuesi: Në çfarë gjendje ishte ai?

Dëshmitari Gjendja e tij ishte pak më mirë se kur e lashë unë. Ai ishte i shtrirë në shtrat, por u përpoq të ngrihej për të thënë tung.

Hetuesi: Çfarë date ishte kjo?

Dëshmitari: Të gjitha këto gjëra kanë ndodhur në korrik. Ai u plagos në fillim të korrikut. Unë e takova në mes të korrikut dhe luftimet ndodhën në fund të korrikut ose fillim të gushtit 1998”

Më 21 shkurt intervista vazhdoi:

“... Hetuesi: Çfarë date ishte kur ju ishit në betejë bashkë me E.Kn dhe ku E.K u plagos?

Dëshmitari: Nuk e mbaj mend datën. Me sa mbaj mend, ishte në fillim të korrikut 1998. Nuk jam i sigurt për datën.

Hetuesi: Sa i sigurt jeni rreth datave?

Dëshmitari: Jam më shumë se 50 për qind i sigurt se E.K u plagos në fillim të korrikut 1998.

Hetuesi: Si ka mundësi që mbani mend se ishte fillimi i Korrikut 1998?

Dëshmitari: Në fund të qershorit, rreth datave 25-27, policia serbe më rrah keq. Besoj se ky incident me E.Kn ka ndodhur rreth 1 javë më pas...”

Më 8 mars 2011, J. K. u mor në pyetje përsëri dhe konfirmoi deklaratat e tij të datës 8 shkurt.

Më 15 mars 2011 ai u mor në pyetje si i pandehur dhe konfirmoi deklaratat e tij të mëparshme; këtë ai e konfirmoi edhe në gjykatë gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në rigjykim.

Gjykata nuk e gjen të besueshëm lidhur me kohën e ngjarjeve. I pandehuri është i sigurt se E.K u plagos në fillim të korrikut, por arsyeja e dhënë nuk është e besueshme.

Gjithashtu gjykata e vë theksin tek marrëdhëniet e tij me E.Kn dhe anëtarësimi i tij në UÇK. Prandaj është e kuptueshme se ai dëshiron të mbrojë trashëgiminë e UÇK-së dhe shokun dhe bashkëpunëtarin e hershëm të tij në UÇK.

Në këto rrethana, gjykata e gjen dëshminë e tij të dyshimtë.

Kur vlerëson të gjitha provat, pjesët kryesore të të cilave u përmendën më lart, gjykata e gjen të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se deklaratat e të pandehurit J.K dhënë para hetuesit të EULEX-it në Prishtinë më 8 shkurt 2011, lidhur me kohën kur u plagos E.K, janë të rreme.

Dëshmia e dëshmitarit H.M

Në deklaratën e tij në gjykatë më 24 janar 2013, H.M deklaroi se ishte në Opterushë dhe se ishte anëtar i UÇK-së dhe ishte bashkuar me UÇK-në pas sulmit në Opterushë. Ai deklaroi më tej se para sulmit mbi Opterushë, ai ishte anëtar i grupit mbrojtës ku funksioni i tij ishte të ndihmonte njerëzit me ushqim e rroba, dhe se ai ishte udhëheqësi i njërit prej dy grupeve në Opterushë, ndërsa E.K ishte udhëheqësi i grupit tjetër në fshat. Në pyetjen e Prokurorit: *A ju kujtohet të keni thënë se ishin 2 grupe të UÇK-së?* H.M deklaroi: *Po.* Më tej, ai dëshmoi se në grupin e UÇK-së të udhëhequr nga E.K ishte edhe vëllai i SO.Bt, ndërsa SO.B u kyç më vonë, pas ofensivës së parë, sepse S., vëllai i SO.Bt, në fillim ishte aktivist; ai u vra dhe pastaj SO.B erdhi për të zëvendësuar vëllain e tij. Deri kohët e fundit ai nuk e dinte kush ishte SO. dhe kush ishte S., gjithçka dinte ai ishte se ata i përkisnin së njëjtës familjeje.

Ai deklaroi se serbët jetonin në fshatin Opterushë si gjithë të tjerët, ata kishin marrëdhënie normale, asgjë e keqe mes tyre dhe ai ishte marangoz dhe punonte për të gjithë. Ai

personalisht dhe me nismën e vet, dy-tre javë apo muaj para sulmit, shkante tek familjet e serbëve dhe diskutonte në lidhje me situatën që po bëhej kërcënuese.

Ai i paralajmëroi familjet se UÇK nga Drenica do të vinte e do të trokiste në dyert e familjeve serbe dhe do të “bënte gjëra të tmerrshme, dhe se ne nuk mund të bënim asgjë për ta penguar këtë”, dhe, kur u pyet nga Prokurori Publik, ai vazhdoi si vijon:

Prokurori: Në korrik të vitit 1998, a ka pasur veprim ushtarak në fshatin Opterushë?

H.M: Fillimisht ishte vetë-mbrojtje dhe pas mesnate u bë sulm.

Kryetarja e trupit gjykues: Çfarë lloj sulmi?

H.M: Nuk ishte nga UÇK-ja, ky ishte një grup që ne nuk mund ta identifikonim, të cilët nuk donin të shkonin as tek shqiptarët, as tek serbët. Gjithë popullata civile ishte në fshat, një grup me maska erdhi dhe sulmoi shtëpitë serbe ...

Prokurori: A ju kujtohet që më keni thënë se Komandanti i këtij grupi kishte një maskë dhe ju i thatë, “ku po shkoni, çfarë doni të bëni?”

H.M: Po. Çdo gjë ndodhi brenda 10 minutave.

Prokurori: A ia thatë atij këtë?

H.M: Po. Gjithashtu thashë, “ju doni ta bëni fshatin Opterushë njëlloj si Srebrenica”.

Prokurori: Çfarë u thatë anëtarëve të grupit tuaj?

H.M: Po. U thashë se grupi im nuk kishte shans të bënte gjëra të tilla.

Prokurori: Pra, ju thatë jo.

H.M: Po.

Prokurori: Çfarë bëtë ju personalisht?

H.M: Thashë që grupi im të mbetet, askush nuk do të shkojë, në vend të kësaj do të shkoj unë.

Prokurori: A ju kujtohet si filloi sulmi?

H.M: Jo, sepse nuk isha atje kur nisi. Unë po shkoja atje dhe isha në mes të rrugës kur filloi sulmi.

Prokurori: A ju kujtohet të keni thënë se disa të UCK-së thjesht hapën zjarr kundër shtëpive serbe, krejt papritur?

H.M: Po. E mbaj mend.

Prokurori: A e dini nëse serbët nga brenda shtëpive iu përgjigjën zjarrit?

H.M: Nuk e di, sepse nuk isha atje që ta dija.

Kryetarja e trupit gjykues: Jam konfuze, ju na thatë se UÇK nuk i sulmoi atë natë shtëpitë serbe dhe tani thoni se sulmoi UÇK, a mund ta shpjegoni?

H.M: Po. Grupi që ju po e quani UÇK, nuk ishte grup i UÇK-së.

Prokurori: Ju thatë se ishte e vërtetë se në një moment ky grup hapi zjarr kundër shtëpive serbe. Pyetja ime është, a keni parë nëse serbët iu përgjigjën zjarrit?

H.M: Sugjeroj që pyetja të bëhet me rregull. Unë thashë se nuk isha aty dhe nuk mund të shihja.

Prokurori: Por ju thatë se në një moment ishte e vërtetë se grupi hapi zjarr.

H.M: Kur tanket kalonin në lumin e Prizrenit, lëkundja mund të dëgjohej në fshatin Opterushë. Zjarri u zhvillua në fshat në mesnatë; ne dëgjuan të shtënat, por nuk e dimë se çfarë ndodhi.

Prokurori: Ju thatë se u thatë njerëzve tuaj se do të ishit i vetmi që do të shkonit. Gjithashtu thatë se të gjithë sulmuesit hapën zjarr në mënyrë të papritur.

H.M: Për ta sqaruar, vendndodhja e njerëzve që u mblodhën për të mbrojtur fshatin ishte 1.5 kilometra larg fshatit, ne nuk kishim tanke ose helikopterë, ne shkonim në këmbë dhe e dëgjuam në mesnatë ...

Prokurori: A e patë E.Kn në ditën e sulmit?

H.M: Ku?

Prokurori: Ju duhet të më tregoni nëse e panë atë.

H.M: Kjo mund të ketë ndodhur në shtëpinë e një fshatari serb në ditën e sulmit.

Prokurori: Kjo nuk është përgjigje; a e patë E.Kn në ditën e sulmit?

H.M: Po, ndërmjet Zocistit dhe fshatit Opterushë.

Prokurori: Çfarë po bënte ai?

H.M: Si të gjithë të tjerët.

Prokurori: Domethënë, çfarë?

H.M: Në vijën e frontit.

Prokurori: A e patë duke folur me njerëzit të cilët kishin ardhur nga Drenica?

H.M: Jo.

Prokurori: A ju kujtohet që më keni thënë se ai foli me njësitin special nga Drenica pak para sulmit?

H.M: Jo. Nuk ishte ashtu.

Prokurori: Si ishte?

H.M: 10 minuta më përpara, njerëzit u mbledhën për t'u organizuar. Lidhur me ngjarjen që ju i referoheni, ky grup arriti 10 minuta para sulmit. Nuk e di sa ishte ora, 11-12, ishte natë, ata ishin të maskuar; urdhri erdhi nga qielli apo kushedi.

Prokurori: A folët me E.Kn para sulmit?

H.M: Po. Ishte bisedë e shkurtër.

Prokurori: Çfarë ju tha ai?

H.M: Se një grup kishte ardhur për të sulmuar shtëpitë serbe dhe unë i thashë se nuk isha fare i interesuar.

Prokurori: Gjatë sulmit ku ishit saktësisht?

H.M: Në mes të rrugës për në fshatrat Zociste dhe Opterushë. Aty ishte pika e takimit e njerëzve të cilët u mobilizuan për të mbrojtur fshatrat. Është në dalje të fshatit Opterushë dhe rrugës prapa fshatit, të shtënat kishin filluar. Ne i dëgjuam të shtënat dhe unë shkova menjëherë në familjen time për ta evakuuar.

Prokurori: A ishit i armatosur?

H.M: Po ...

Prokurori: Kur patë E.Kn, a ishte ai i armatosur si ju?

H.M: Nuk pashë për armë, ishte natë, nuk më interesonte të shihja a kishte armë apo jo.

Dëshmitari H.M tha se e ka parë E.Kn gjatë natës në mes të 17 dhe 18 korrikut 1998 mes Zocishtit dhe Opterushës dhe se ai vetë, kur filloi sulmi, ishte në mes të rrugës ndërmjet Zocishtit dhe Opterushës, ku ishte pika e takimit të njerëzve që mobilizoheshin për të mbrojtur fshatin, dhe kur ishte duke u kthyer në fshat, kishin filluar të shtënat; menjëherë ai shkoi të evakuonte familjen e tij. Pika e mobilizimit për mbrojtjen e fshatrave ishte 1.5 kilometra larg fshatit. Lidhur me SO.Bn, dëshmitari nuk tha asnjë dëshmi në lidhje me praninë e Bt në fshatin Opterushë.

Duke pasur parasysh faktin se të pandehurit MU.H, MI.H, N.H, N.B dhe J.K dëshmuan të gjithë në mbështetje të E.Kt, se ai u plagos para sulmi të ndodhur në Opterushë, nga ana tjetër se dëshmitari H.M dëshmoi në gjykatë se e ka parë E.Kn në ditën e sulmit midis fshatit Zocistë dhe fshatit Opterushë, dhe duke marrë parasysh deklaratat e besueshme të dëshmitareve D.B dhe S. B. dhe duke i parë këto në lidhje me deklaratat e të pandehurve të tjerë, gjykata e gjen deklaratën e mësipërme të dhënë nga H.M të besueshme, domethënë, se E.K nuk u plagos para sulmit.

Siç e sheh gjykata, dëshmitari H.M nuk dha asnjë provë në gjykatë në lidhje me praninë dhe pjesëmarrjen e E.Kt dhe SO.Bt në sulmin gjatë natës midis 17 dhe 18 korrikut 1998. Prandaj, lidhur me dëshminë e M., gjykata nuk mundi të gjejë ndonjë provë se të pandehurit E.K dhe

SO.B morën pjesë në sulmin e natës së 17 të korrikut dhe orëve të hershme të mëngjesit të 18 korrikut 1998.

Gjykata është e mendimit se deklaratat e mëparshme të H.Mt, të dhëna në cilësinë e të akuzuarit para Prokurorit ose në Gjykatë, nuk mund të përdoren si provë në këtë shqyrtim gjyqësor, pasi këto deklaratat u morën prej tij në cilësinë e të akuzuarit, ndërsa në këtë moment H.M është vetëm dëshmitar në këtë shqyrtim gjyqësor.

Prandaj, gjykata ka vendosur të mos i përdorë si provë deklaratat e mëparshme të H.Mt të dhëna në cilësinë e të akuzuarit para prokurorit publik ose në gjykatë, me dijeninë se, duke dhënë deklaratë në cilësinë e të akuzuarit, H.M kishte të drejta dhe detyrime të caktuara (neni 356 paragrafi 2 i KPPK-së), që këtu janë të ndryshme nga të drejtat dhe detyrimet e dëshmitarit (neni 164 paragrafi 2 i KPPK-së).

Dëshmitari A.B,

Në shqyrtimin e parë gjyqësor më 30 qershor 2011, A.B dëshmoi se në vitin 1998 ishte mësues, dhe se nuk ishte anëtar i UÇK-së. Ai kujtoi shtënat në Opterushë dhe deklaroi se ato zgjatën nga mesnata deri në mëngjes, por ai nuk e dinte datën dhe çfarë po ndodhte, kush po luftonte kundër kujt. Ai mori vesh të nesërmen se serbët e fshatit kishin luftuar kundër UÇK-së.

A.B dëshmoi para hetuesit të EULEX-it më 31 janar 2011, ku deklaroi se ai nuk ishte anëtar i UÇK-së dhe nuk ka pasur anëtarë nga fshati Opterushë me uniforma apo armë. Ai ishte në shtëpi natën kur filluan luftimet. Ato filluan pas mesnate dhe zgjatën deri në mëngjes. Ai dëgjoji shumë shtëna dhe nuk e di se kush po luftonte kundër kujt.

A.B dëshmoi para hetuesit të EULEX-it më 15 maj 2012.

Hetuesi e pyeti nëse kishte pasur ndonjë luftim në fshatin Opterushë para natës në qershor 1998, kur UÇK i kishte larguar serbët nga shtëpitë e tyre dhe i kishte transportuar në Suharekë?

Dëshmitari deklaroi se ishte hedhur një granatë dhe ajo kishte shpërthyer afër një shtëpie në afërsi të qendrës. Pronari i shtëpisë ishte H. B.. Ai jetonte në Francë në atë kohë. Në shtëpi nuk ishte askush.

Ai dëshmoi gjatë shqyrtimit gjyqësor më 25 janar 2013 dhe konfirmoi deklaratën e tij të mëhershme të dhënë në shqyrtimin e parë gjyqësor më 30 qershor 2011.

Deklaratat e dhëna nga dëshmitari nuk ofrojnë ndonjë provë vendimtare lidhur me kohën kur u plagos E.K apo nëse ai e pa E.Kn dhe/ose SO.Bn duke marrë pjesë në sulmin kundër familjeve serbe në natën e 17 korrikut dhe në orët e hershme të mëngjesit të 18 korrikut 1998.

Dëshmitari F.M,

Kur dha dëshmi në gjykatë në shqyrtimin e parë gjyqësor më 30 qershor 2011, ai deklaroi:

Prokurori Publik: A ju kujtohet nëse në një moment të caktuar në fshatin tuaj ka pasur luftë?

F.M: Unë nuk isha atje në kohën kur ka ndodhur luftimi.

Prokurori Publik: A ju kujtohet kur ka ndodhur ky luftim pak a shume?

F.M: Nuk e mbaj mend, sepse lëvizëm nga fshati ynë dhe shkuam në një fshat tjetër.

Prokurori Publik: Po pyes nëse ju kujtohet viti dhe muaji.

F.M: Në korrik 1998, ne ishim praktikisht larg shtëpisë. Ne nuk qëndruam atje.

Në dëshminë e dhënë në shqyrtimin gjyqësor më 25 janar 2013, dëshmitari F.M deklaroi se kujton se, kur shtëpia e A.Bt u godit nga një granatë, gjithë popullsia ishte ende në fshat, shqiptarë dhe serbë, dhe pas granatimit popullsia u zhvendos.

Deklaratat e dhëna nga dëshmitari nuk japin asnjë dëshmi vendimtare lidhur me kohën se kur u plagos E.K, apo nëse ai e pa E.Kn dhe/ose SO.Bn duke marrë pjesë në sulmin kundër familjeve serbe në natën e 17 korrikut dhe deri në orët e mëngjesit të 18 korrikut 1998.

Dëshmitari P. M., kur dha dëshmi para hetuesit të EULEX-it më 13 janar 2011, deklaroi se ai ishte anëtar i UÇK-së nga vjeshta e vitit 1998.

Hetuesi: A e dini nëse E.K u plagos gjatë luftës?

Dëshmitari: Nuk e di. Kam dëgjuar se ai u plagos, por nuk e di se ku apo kur.

Hetuesi: A mund të ketë qenë i plagosur para sulmit mbi shtëpitë e serbëve?

Dëshmitari: Jo, nuk ka qenë, me siguri. Duhet të ketë qenë më vonë ...

Më tej, ai deklaroi se ai e njihte SO.Bn. Ata kishin jetuar në të njëjtin fshat para luftës. Pas luftës SO. u zhvendos në Rahovec. Dëshmitari nuk ishte i sigurt nëse SO.B ka qenë në UÇK.

Në dëshminë e dhënë para gjykatës më 30 qershor 2011, ai deklaroi më tej se në korrik 1998 ai ishte në fshatin Oterushë, dhe u zhvendos nga fshati i tij, pasi kishte filluar lufta, para agimit, duke kujtuar se të shtënat zgjatën gjithë natën. Ai deklaroi se e njeh E.Kn dhe kishte dëgjuar se E. ishte plagosur, por ai nuk e di se kur dhe ku ishte plagosur E.

Deklaratat e dhëna nga dëshmitari nuk japin asnjë dëshmi vendimtare lidhur me kohën kur u plagos E.K, apo nëse ai e pa E.Kn dhe/ose SO.Bn duke marrë pjesë në sulmin kundër familjeve serbe në natën e 17 korrikut dhe në orët e hershme të mëngjesit të 18 korrikut 1998.

Dëshmitari N.M,

Kur dëshmoi para hetuesit të EULEX-it më 19 janar të vitit 2011, ai deklaroi, mes tjerash, si vijon:

“....

Hetuesi: A ju kujtohet ndonjë pjesëtar i UÇK-së nga Opterusha?

Dëshmitari: E.K ishte komandant

Hetuesi: A e dini se kur u kyçën ata në UÇK?

Dëshmitari: Mendoj se ata u bënë anëtarë të UÇK-së një muaj para sulmit në shtëpitë e serbëve.

Hetuesi: A e njihni E.Kn?

Dëshmitari: Ne jemi nga i njëjti fshat. Unë e kam njohur atë që kur ishte djalë. Ai është rreth 20 vjet më i ri se unë.

....

Hetuesi: A kishte ai ndonjë gradë?

Dëshmitari: Ai ishte komandant i UÇK-së në Opterushë në kohën kur serbët u dëbuan nga shtëpitë e tyre. Ai ka arsim të mirë.

Hetuesi: A u përfshi E.K në luftimet në Opterushës?

Dëshmitari: Nuk e di.

.... “

Hetuesi: A e njihni SO.Bn?

Dëshmitari: E njoh, sepse është nga i njëjti fshat. Kurrë nuk kam folur me të.

....

Hetuesi: A ishte E.K komandanti i tij.

Dëshmitari: Po, sepse E. ishte komandant në atë kohë në Opterushë.

Ai dëshmoi gjatë shqyrtimit gjyqësor më 28 janar 2013 dhe konfirmoi deklaratën e tij të mëhershme të dhënë në shqyrtimin e parë gjyqësor më 30 qershor 2011.

Deklaratat e tij në shqyrtimin publik u ndryshuan në mënyrë të konsiderueshme dhe ai ishte shumë më i pasigurt. Gjykata e kupton këtë si përpjekje të dëshmitarit për të mbrojtur dhe ndihmuar të pandehurin E.K dhe, prandaj, i gjen këto deklarata më pak të besueshme se deklaratat e tij të mëparshme të cituara më lart para hetuesit të EULEX-it.

Megjithatë, deklaratat e dhëna nga dëshmitari nuk japin asnjë provë vendimtare lidhur me kohën kur u plagos E.K, apo nëse ai i pa E.Kn dhe/ose SO.Bn duke marrë pjesë në sulmin kundër familjeve serbe në natën e 17 korrikut dhe në orët e hershme të mëngjesit të 18 korrikut 1998.

Dëshmitari A.H

Pasi kryetarja e trupit gjykues u konsultua me të gjitha palët, përfshirë mbrojtësit dhe secilin të pandehur, u ra dakord që deklarata e Dr. A.Ht e datës 30 qershor 2011 të lexohej dhe të përfshihej në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor.

Dr. A.H punonte si kirurg. Dr. H. mjekoi të pandehurin e plagosur E.K. Deklarata e tij në shqyrtimin e parë gjyqësor ishte dukshëm më e pasigurt se deklarata e tij e mëparshme para hetuesit të EULEX-it më 21 dhjetor 2010. Gjykata e gjen deklaratën e tij para hetuesit më të besueshme, sepse ajo kupton se deklarata e tij në shqyrtimin e parë gjyqësor ishte nën presionin e ngurrimit kur dëshmoi kundër të pandehurit E.K. Gjykata nuk gjen arsye përse ai duhet t'i deklaronte hetuesit diçka që nuk ishte e vërtetë. Deklarata e tij në gjykatë, e dhënë më 30 qershor 2011, për rrjedhojë, nuk konsiderohet po aq e besueshme sa deklarata e tij para hetuesit të EULEX-it më 21 dhjetor 2010.

Para hetuesit ai deklaroi si vijon më 21 dhjetor 2010:

“.....

Hetuesi: A regjistroni ju ose stafi juaj çdo pacient?

Dëshmitari: Unë mund të them se 95% e pacientëve u regjistruan. Por, kur kishim raste shumë urgjente, nuk arrinim t'i regjistronim të gjithë. Sistemin që përdorja, e kam krijuar vetë.

.....

Hetuesi: A e keni gjetur atë (E.Kn) në ato dhëna të regjistruara?

Dëshmitari: Po. Megjithëse fillimisht nuk munda ta mbaj mend se kisha pasur një pacient për 2 javë, gjeta të vetmin regjistrim për këtë pacient, dhe ju mund të përcaktoni lehtë se regjistri i tij është kopje e origjinalit. Ky regjistër është dokumenti i vetëm i disponueshëm ku janë regjistruar të dhënat kryesore lidhur me pacientët. Në regjistrin që ju dorëzova sot, datat fillojnë më 4 gusht 1998 dhe përfundojnë më 1 shtator 1998. Çdo faqe është e ndarë në 4 kolona. Kolona 1 është numri i pacientit. Kolona 2 është emri dhe të dhënat personale të pacientit. Kolona 3 është diagnoza dhe kolona 4 është mjekimi. Nuk mund të mbanim ndonjë bllok tjetër shënimesh.

Hetuesi: A mund të përshkruani shënimet përkatëse për E.Kn.

Dëshmitari: Data e regjistrimit është 12 gusht 1998. Numri i pacientit ose protokollit është 1199. Emri është E.K. Viti i lindjes 1965. Vendi i lindjes është Opterushë. Diagnoza është shënuar në latinishte si: “Vulnus Sclopeteorium, Regio Lat. Dex “, që do të thotë: plagë me armë zjarri në anën e djathtë. Që të jemi të përpiktë, duket se asistenti im nuk ka mundur të më ndjekë me saktësi në lidhje me vendndodhjen e saktë të lëndimit në trup. Nëse i referohem asaj që është shkruar, nuk është saktësisht e qartë se ku ishte lëndimi. Kolona numër 4, mjekimi i caktuar, ishte vetëm për 4 ditë terapi, domethënë, ai mori ilaçet për 4 ditë. Ilaçi ishte penicilinë dhe 4 ditë gentamicinë me injeksion. Jam më se i sigurt, duke përdorur logjikën time, se, nëse ai do të kishte qenë

në spital për 2 javë, unë do ta kisha mbajtur mend. Nëse i referohem protokollit lidhur me lëndimet e tij, ai me siguri ka qëndruar në spital maksimumi 1 ose 2 ditë. Por nga këto shënime në regjistër, besimi im është se ai ka qëndruar si pacient vetëm 1 ditë. Ai ishte pacienti i 13 atë datë.

Hetuesi: Pra, për ta qartësuar, ky regjistrim është për datën 12 gusht 1998. A është ky i vetmi regjistrim që keni për mjekimin e E.Kt.

Dëshmitari: Jam 99% i sigurt se ky është regjistrimi i vetëm që kam për E.Kn. Mund të ketë ndonjë përjashtim, por nuk mendoj kështu.

Hetuesi: Sipas mendimit tuaj më të mirë, a e keni trajtuar E.Kn në korrik 1998 për një plagë me armë zjarri?

Dëshmitari: Unë nuk kam ndonjë regjistrim tjetër për të dhe nuk e mbaj mend atë. Mund vetëm t'i referohem këtij dokumenti zyrtar.

Hetuesi: Çfarë spitali i referohet ky regjistrim?

Dëshmitari: Ishte Breshance. Distanca midis Breshances dhe Gajrakut është afërsisht 7 ose 8 km.

Hetuesi: A e njihni fshatin Rugovë e Hasit?

Dëshmitari: Po.

Hetuesi: Nëse dikush plagosej në atë fshat, ku do ta dërgonin?

Dëshmitari: Zakonisht kudo ku do të isha unë, por vetëm nga atje. Nuk ka pasur ndonjë vend tjetër për të shkuar. Njerëzit vinin nga gjithandej, madje edhe nga shumë larg.

Hetuesi: Pra, megjithëse ju lëviznit nga një objekt në tjetrin, të plagosurit i sillnin aty ku ndodheshit ju?

Dëshmitari: Po, ata pyesnin ku ndodhesha unë dhe vinin tek unë. Për disa kohë unë isha në të vetmin objekt mjekësor që funksiononte në Kosovë. Madje disa shënime në këtë dokument u referohen pacientëve nga Prishtina.

Hetuesi: A keni ndonjë shënim të ngjashëm për korrikun 1998?

Dëshmitari: Po, mund t'ju jap edhe atë. Në të nuk ka shënim për E.Kn për muajin korrik 1998. Por, kur e shoh, di që isha në Gajrak në atë kohë.

Hetuesi: Duke parë shënimet që keni për E.Kn, a mund të thoni se kur e ka marrë ai lëndimin e tij?

Dëshmitari: Jo, nuk mund ta them këtë, ne nuk ishim në gjendje të mbanim shënim shumë detaje. Ky shënim tregon se ai me siguri ishte pacient i jashtëm atë ditë. Meqë po kërkoni detaje të veçanta, unë nuk mund të them me saktësi se kur e ka marrë lëndimin e tij, por, siç kam thënë, nuk kam asnjë shënim për E.Kn për datat 11 ose 12 korrik 1998

Sipas dëshmisë së Dr. A.Ht, ai me shumë gjasa do ta kishte mbajtur mend në qoftë se E.K do të kishte qenë në spital për 2 javë. Duke iu referuar protokollit me lëndimet e K., Dr. H. deklaroi se është më se e mundshme që E.K të ketë qëndruar në spital për maksimumi 1 ose 2 ditë. Megjithatë, Dr. H. nuk e mbante mend E.Kn të shtruar në spital, kur ishte plagosur.

Gjatë shqyrtimit të parë gjyqësor më 30 qershor 2011, Dr. A.H vazhdoi kështu, kur u pyet nga Prokurori Publik:

Prokurori Publik: A mbanit shënime për pacientët tuaj?

Dr. A.H: Po, por kjo nuk do të thotë se i kam mbajtur të gjitha shënimet, për shkak të lëvizjeve; ne i blinim vetë fletoret dhe i mbanim shënimet në këto fletore. Ne kemi të dhëna për 12,000 pacientë të regjistruar, por është e sigurt se kemi mjekuar rreth 20.000 pacientë.

Prokurori Publik: A u regjistruan të gjithë pacientët tuaj në regjistër?

Dr A.H: Jo të gjithë, thashë jo.

Prokurori Publik: Hetuesit të EULEX-it në datën 21 dhjetor 2010 ju iu përgjigjët, mund të them se 95% e pacientëve u regjistruan.

Dr. A.H: Ndoshta e kam thënë këtë, por kjo është në dy ose tre vende, informacioni arkivor kishte mbetur në terren dhe për shkak të lagështirës dhe shiut ky informacion u dëmtua ose u shkatërrua. Pra, po të kemi parasysh edhe këtë informacion të dëmtuar, shifra mund të shkojë në këtë numër që sapo përmenda. Dhe unë mund t'ju jap numrin e saktë, 11,635 pacientë.

Prokurori Publik: A mbajtët kopje të të dhënave?

...

Dr. A.H: Po, kam bërë kopje.

Prokurori Publik: A ia keni dorëzuar ndonjë nga këto kopje ndonjë hetuesi?

Dr. A.H: Po, dhe nuk ma kthyen.

.....

Prokurori Publik: A ju kujtohet ku e gjetët emrin e tij në regjistër?

Dr. A.H: Nëse nuk gaboj, më 12 gusht 1998.

Prokurori Publik: A mund ta shikoni në këtë bllok shënimesh ...

Dr. A.H: Po, ky është blloku im, faksimilja ime, fotokopje e dokumentit tim origjinal.

....

Prokurori Publik: A mund të na tregoni, nëse është e mundur, shënimin për pacientin në fjalë?

Dr. A.H: Këtu, më 12 gusht me numër protokolli 1199.

Prokurori Publik: A mund të na e thoni emrin e personit të regjistruar?

Dr. A.H: E.K lindur më 1965 në Optrushë.

Prokurori Publik: Në atë bllok që keni në duar, a keni gjetur ndonjë shënim tjetër për të njëjtin person?

Dr A.H: Jo, nuk kam gjetur.

Prokurori Publik: A i kontrolluat edhe shënimet, ose kopjen e shënimeve që keni mbajtur, e kam fjalën për muajin korrik 1998?

Dr. A.H: Mendoj se po, por nuk mund të jem i saktë në lidhje me këtë.

Prokurori Publik: Hetuesit të EULEX-it për të njëjtin rast i keni thënë: “Nuk ka asnjë shënim për E.Kn për muajin korrik 1998 në bllok”.

Dr. A.H: Edhe tani po them se në përgjithësi nuk gjeta ndonjë të dhënë në shënimet, por nuk mund ta përjashtoj mundësinë, për shkak të numrit të madh të pacientëve, pasi kishte raste kur 150 pacientë ishin në radhë për t’u kontrolluar.

Prokurori Publik: Ajo që po thoni është e ndryshme, ju po thoni se ndoshta ai erdhi dhe nuk u regjistrua. Unë po ju pyes nëse e gjetët emrin e tij në shënimet për muajin korrik 1998.

Dr. A.H: Jo, nuk e gjeta.

Prokurori Publik: Nuk e gjetët?

Dr. A.H: Jo, përveç asaj që thashë këtu në këtë libër.

Kur e vlerëson dëshminë në tërësi, pjesët kryesore të së cilës u përmendën më sipër, gjykata e gjen më të besueshme deklaratën e dëshmitarit A.H dhënë para hetuesit të EULEX-it, lidhur me kohën kur u plagos E.K.

Më 21 dhjetor 2010, Dr. A.H i dorëzoi hetuesit të NJHKL-së kopje të regjistrit që mbante në atë kohë, që përmbante emrin e E.Kt, data e hyrjes 12 gusht 1998, numri i pacientit ose protokollit 1199, viti i lindjes 1965, vendi i lindjes Optrushë. Diagnoza është shënuar në latinisht, si: “Vulnus Sclopeteorium, Regio Lat. Dex”, që do të thotë plagë me armë zjarri në anën e djathtë.

Bazuar në të njëjtën dëshmi të lartpërmendur të Dr. A.Ht, gjykata gjen se E.K u plagos në gusht 1998, domethënë, pas sulmit.

Gjykata vë në dukje, megjithatë, se ka disa paqartësi në lidhje me mjekimin që mori i pandehuri E.K, në veçanti nëse ai u shtrua në spital apo jo.

VIII. Vlerësimi ligjor për krimet e luftës

Ekzistenca e konfliktit të brendshëm të armatosur

Konflikti i armatosur ekziston sa herë që kalohet në përdorimin e forcave të armatosura, qoftë ndërmjet shteteve, ose në dhunë të armatosur të zgjatur.

Sipas Aktgjykimit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (ICTY), 3 prill 2008, faqet 56-57, paragrafi 100 (Lënda IT-04-84), Kolegji i Shqyrtimit Gjyqësor “*është i bindur se ekzistonte një konflikt i armatosur në Kosovë nga data dhe përfshirë datën 24 prill 1998 e tutje. Kolegji i Shqyrtimit Gjyqësor ka marrë një sasi voluminoze provash treguese të konfliktit të armatosur nga maji deri në shtator të vitit 1998.*”

Në Aktgjykimin e ICTY-së të datës 23 shkurt 2011, paragrafi 1579, faqja 629 (Lënda IT-05-87/1-T), Kolegji konkludoi se “*deri në fund të majit 1998, në Kosovë ekzistonte një konflikt i armatosur ndërmjet forcave serbe, në veçanti, forcave të UJ-së dhe MPB-së, dhe UÇK-së. Ky konflikt i armatosur vazhdoi së paku deri në qershor të vitit 1999.*”

Lidhur me Kosovën, konsiderohet se atje ekzistonte një konflikt i brendshëm (në mes të forcave serbe dhe forcave të UÇK-së) dhe një konflikt ndërkombëtar (midis NATO-s dhe forcave serbe në Kosovë nga data 24 mars 1999 deri më 10 qershor 1999).

Bazuar në këtë, Gjykata është e bindur se në kohën e sulmit në fshatin Opterushë më 17 dhe 18 korrik 1998, në Kosovë ekzistonte një konflikt i brendshëm i armatosur.

Nenet e cituara nga Konventat e Gjenevës (Neni 3 i Përbashkët dhe Neni 13.2.) janë të zbatueshme për konfliktet e brendshme të armatosura, prandaj edhe për konfliktin në Kosovë.

Statusi civil (i mbrojtur) i viktimave

Neni 3 i përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të datës **12 gusht 1949 (Neni 3 i Përbashkët)** dhe Neni 13.2 i Protokollit II Shtesë të datës 8 qershor 1977, të Konventave Gjenevës të vitit 1949 (**Protokolli II Shtesë**).

Neni i Përbashkët 3 thekson ndër të tjera se

- (1) *Personat që nuk marrin pjesë aktive në luftime, ..., trajtohen në të gjitha rrethanat në mënyrë njerëzore, pa asnjë dallim të kundërt të bazuar në racën, ngjyrën, fenë apo besimin, lindjen apo pasurinë, apo ndonjë kriter tjetër të ngjashëm. Për këtë qëllim, aktet në vijim janë dhe do të mbeten të ndaluara në çdo kohë dhe në çdo vend, cilido qoftë, në lidhje me personat e lartpërmendur:*
- (2) (a) *dhuna ndaj jetës dhe personave, në veçanti, vrasja e të gjitha llojeve, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura “*

Neni 13.2 i Protokollit II pohon sa vijon:

“2. Popullata civile si e tillë, si edhe civilët si individë, nuk duhet të jenë objekt sulmi. Aktet ose kërcënimet për dhunë, qëllimi parësor i të cilave është të përhapin terror në mesin e popullsisë civile, ndalohen.”

Bazuar në konkluzionet e përmendura më herët, gjykata e gjen të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se sulmi më 17 dhe 18 korrik 1998 u drejtua ndaj popullatës civile serbe të Optrushës.

Më 17 dhe 18 korrik 1998, shtëpia serbe ishte e zënë nga persona civilë serbë, këtë Gjykata e gjen provuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Asnjë prej personave të përmendur që ishin mbledhur në shtëpinë B., nuk kishte status tjetër përveç atij civil.

Më tej, bazuar në deklaratat e dëshmitareve, gjykata e gjen të vërtetuar se serbët e mbledhur në shtëpinë e dëshmitares kishin armë në zotërim të tyre, përfshirë pushkë dhe pistoleta, dhe se këto armë u përdorën më 17 dhe 18 korrik 1998.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata nuk pati tregues se këto armë u përdorën për ndonjë qëllim tjetër, përveç vetëmbrojtjes nga ana e meshkujve serbë të mbledhur në shtëpi, kur u sulmuan.

Mbi këtë bazë – dhe parë në lidhje me të gjitha dëshmitë e tjera të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor – gjykata gjen të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të gjithë serbët e mbledhur në shtëpinë e dëshmitares më 17 dhe 18 korrik 1998 ishin civilë të cilët nuk po merrnin pjesë në luftimet midis forcave të UCK-së dhe Ushtrisë Jugosllave (serbe), që u zhvilluan nga prilli 1998 deri në mes të korrikut 1999. Ata ishin, kështu, nën statusin e mbrojtur si civilë nga Neni 3 i Përbashkët, i përmendur më lart, dhe Neni 13.2 i Protokollit II.

Gjykata gjen se sulmi i forcave të armatosura më 17 dhe 18 korrik 1998 kundër popullatës civile serbe të Optrushës, të mbledhur në shtëpinë e dëshmitares D.B, ishte në kundërshtim me Nenin 3 të Përbashkët të Konventave të Gjenevës, dhe Nenin 13.2 të Protokollit II, pasi të dy këto nene kanë të bëjnë me mbrojtjen e civilëve të cilët nuk janë përfshirë në konflikt të armatosur ose pjesë të tij.

Sulmi i armatosur më 17 dhe 18 korrik 1998 ishte në kundërshtim me Nenin e Përbashkët 3 (1) (a) që ndalon dhunën ndaj jetës dhe personit. Sulmi me armë zjarri gjatë gjithë natës pa dyshim përbënte një rrezik serioz për jetën e popullatës civile serbe brenda shtëpisë që u sulmua.

Sulmi më 17 dhe 18 korrik 1998 mbi shtëpitë serbe ku ishte mbledhur popullsia civile serbe e Optrushës dhe siç u përshkrua më sipër, përbën sulm të armatosur mbi popullsinë civile, veprim i ndaluar dhe i dënueshëm nga nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, tani veprë e dënueshme nga Nenet 31 dhe 153 paragrafët / (2.1) dhe (2.14) të KPRK-së, dhe shkelje të Nenit 3 të Përbashkët të katër Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, dhe Nenit 13.2 të Protokollit II Shtesë të datës 8 qershor 1977 të Konventave Gjenevës të vitit 1949 (Protokollit II Shtesë), të gjitha rregullave të së drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë.

IX. Përfundim

Pyetja është: A morën pjesë E.K dhe SO.B, në bashkëpunim me njerëz të tjerë të paidentifikuar, në sulmin ndaj popullatës civile serbe më 17 dhe 18 korrik 1998?

Gjykata e gjen të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se E.K ishte i pranishëm dhe i armatosur me një pushkë në oborrin e shtëpisë serbe në mëngjesin e 18 korrikut 1998, pas ndërprerjes së shkëmbimit të zjarrit.

Lidhur me pyetjen nëse ai mori pjesë në sulm, gjykata vë në dukje sa vijon:

Gjykata e gjen jo të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm praninë e E.Kt në mbrëmjen e 17 korrikut deri në mëngjesin e 18 korrikut 1998 gjatë sulmit mbi shtëpinë serbe dhe prania e tij në oborrin e shtëpisë në mëngjesin e 18 korrikut 1998, menjëherë pasi u dorëzuan serbët dhe kishte përfunduar sulmi, nuk është e mjaftueshme për të vërtetuar pjesëmarrjen e tij në sulm.

Të dëmtuarat D.B dhe S.B në dëshmitë e tyre para prokurorit dhe në gjykatë nuk kanë dhënë asnjë detaj në lidhje me lëvizjet e E.Kt, veprimet e tij, ose nëse E.K ka dhënë ndonjë urdhër, në mëngjesin e 18 korrikut 1998 në oborrin B., pas ndërprerjes së shkëmbimit të zjarrit. Gjykata e gjen të provuar se E.K ishte i pranishëm në oborrin e shtëpisë në mëngjesin e 18 korrikut 1998, menjëherë pasi u dorëzuan serbët dhe kishte përfunduar sulmi. Por materialet provuese të mbledhura nuk provojnë se kur hyri në oborrin e shtëpisë E.K, për çfarë arsye dhe me ç'qëllim.

Rrjedhimisht, gjykata është e detyruar t'i interpretojë të gjitha dyshimet lidhur me ekzistimin e fakteve relevante në të mirë të të pandehurit.

Bazuar në këtë, E. K. nuk mori pjesë në sulmin kundër shtëpisë serbe në natën e 17 korrikut deri në mëngjesin e hershëm të 18 korrikut 1998 dhe prandaj ai shpallet jo fajtor.

A mori pjesë SO.B në sulmin ndaj popullatës civile serbe?

Gjykata e gjen të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se SO.B ishte i pranishëm dhe i armatosur me pushkë në oborrin e shtëpisë serbe në mëngjesin e 18 korrikut 1998, pasi kishte ndaluar shkëmbimi i zjarrit.

Lidhur me pyetjen nëse ai mori pjesë në sulm, gjykata vë në dukje sa vijon:

Gjykata e gjen jo të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm praninë e SO.Bt në mbrëmjen e 17 korrikut deri në mëngjesin e 18 korrikut 1998, gjatë sulmit mbi shtëpinë serb, dhe prania e tij në oborrin e shtëpisë në mëngjesin e 18 korrikut menjëherë pasi u dorëzuan serbët dhe kishte përfunduar sulmi, nuk është e mjaftueshme për të vërtetuar pjesëmarrjen e tij në sulm.

Të dëmtuarat D.B dhe S.B, në dëshmitë e tyre para prokurorit dhe në gjykatë, nuk dhanë asnjë

detaj në lidhje me lëvizjet e SO.Bt, veprimet e tij, apo nëse SO.B dha ndonjë urdhër në mëngjesin e 18 korrikut 1998 në oborrin B. pasi kishte pushuar shkëmbimi i zjarrit. Gjykata e gjen të provuar se SO.B ishte i pranishëm në oborrin e shtëpisë në mëngjesin e 18 korrikut 1998, menjëherë pasi u dorëzuan serbët dhe kishte përfunduar sulmi. Por materialet provuese të mbledhura nuk provojnë se kur hyri SO.B në oborrin e shtëpisë, për çfarë arsye dhe për ç'qëllim.

Rrjedhimisht, gjykata është e detyruar t'i interpretojë të gjitha dyshimet lidhur me ekzistimin e fakteve relevante në të mirë të të pandehurit.

Bazuar në këtë, SO. B. nuk mori pjesë në sulmin kundër shtëpisë serbe në natën e 17 korrikut deri në mëngjesin e hershëm të 18 korrikut 1998 dhe prandaj ai shpallet jo fajtor.

Gjykata u referohet deklaratave të dëshmitareve D.Bdhe S.B, të cilat deklaruan të dyja se e panë "J.", E.K, dhe SO.Bn në mesin e njerëzve në oborrin e shtëpisë, pasi u dorëzuan serbët, në mëngjesin e 18 korrikut 1998.

Gjykata i gjen deklaratat e dëshmitareve D.Bdhe S.B të besueshme lidhur me këtë çështje. Në lidhje me këtë, gjykata vë në dukje deklaratat e tyre të ngjashme në këtë aspekt, të cilat gjykata i gjen gjithashtu të logjikshme. Për më tepër, ato kanë qenë të njëjta me deklaratat e tyre gjatë hetimit dhe shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata i gjen deklaratat e dëshmitareve D.B dhe S.B. të besueshme lidhur me njohjen dhe identifikimin nga ana e tyre të të pandehurve E.K dhe SO.B, dhe se këta ishin të dy të pranishëm në oborrin e shtëpisë së dëshmitares D.Bnë mëngjesin e 18 korrikut 1998.

Gjykata nuk ka dyshime nga deklaratat e dhëna nga dëshmitaret D.Bdhe S.B se të dy të pandehurit, E.K dhe SO.B, ishin të armatosur me pushkë, ndërsa hynë në oborr. Megjithatë, gjykata konkludon se këto rrethana nuk janë plotësisht të mjaftueshme për të përfunduar përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit E.K dhe SO.B janë përgjegjës dhe morën pjesë në sulmin kundër shtëpisë serbe në natën e 17 korrikut deri në mëngjesin e hershëm të 18 korrikut 1998.

Dëshmitaret D.Bdhe S.B nuk dhanë asnjë dëshmi para gjykatës se të pandehurit E.K dhe SO.B morën pjesë në sulm gjatë natës së 17 dhe 18 korrikut 1998, pasi femrat serbe, bashkë me dëshmitaret D.Bdhe S. B., u strehuan në bodrum nga koha kur filluan të shtënat në natën e 17 korrikut, deri në mëngjesin e hershëm të 18 korrikut 1998, kur të gjithë serbët u dorëzuan.

Bazuar në këto rrethana, gjykata e gjen të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se E.K dhe SO.B ishin të pranishëm në oborrin e shtëpisë B. menjëherë pas pushimit të shkëmbimit të zjarrit, por prania e E.Kt dhe SO.B në oborrin e shtëpisë së dëshmitares D.B menjëherë pas pushimit të shkëmbimit të zjarrit nuk provon se të pandehurit E.K dhe SO.B morën pjesë në sulmin në natën e 17 korrikut dhe në orët e hershme të mëngjesit të 18 korrikut 1998. Fakti që

të pandehurit ishin të pranishëm në oborrin e shtëpisë së dëshmitares D.B menjëherë pas pushimit të shkëmbimit të zjarrit, nuk përbën bazë për dënim.

Nga ana tjetër, gjykata i gjen jo të besueshme deklaratat e dhëna nga E.Kt lidhur me praninë e tij më 17 dhe 18 korrik 1998 dhe kohën kur ai u plagos. Bazuar në dëshminë e lart-përmendur të Dr. A.Ht, gjykata gjen se E.K u plagos në gusht të vitit 1998, domethënë, pas sulmit.

Për më tepër, gjykata i gjen jo të besueshme deklaratat e SO.Bt lidhur me praninë e tij më 17 dhe 18 korrik 1998, kur ai deklaroi se nga fundi i qershorit ose fillimi i korrikut ai ishte në fshatin Samadraxhë, ku ai qëndroi për katër muajt vijues tek daja i tij. Kur shqyrton deklaratat e besueshme të dëshmitareve D.B dhe S. B., dhe i sheh në lidhje me deklaratat e të pandehurve të tjerë, gjykata i gjen jo të besueshme deklaratat e dhëna nga i pandehuri SO.B.

Bazuar në provat dhe dëshmitë e paraqitura në gjykatë, gjykata nuk është në gjendje të provojë lëvizjet dhe vendndodhjen e E.Kt dhe SO.Bt gjatë natës ndërmjet 17 korrikut deri në mëngjesin e hershëm të 18 korrikut 1998.

Të pandehurit E.K dhe SO.B janë liruar nga akuza për shkak se nuk u provua se ata e kryen veprën me të cilën janë akuzuar.

Të pandehurit MU.H, MI.H, N.H, N.B dhe J.K

Për mendimin e gjykatës, përshkrimi ose përmbajtja e veprës penale të dhënies së ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale, të përshkruar në nenin 305 të Kodit Penal të Kosovës dhe nenin 307 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr. 04/L-082), janë të ngjashme. Prandaj, në bazë të nenit 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për kryerësit do të zbatohet ligji në fuqi në kohën kur u krye vepra penale.

Të pandehurit MU.H, MI.H, N.H, N.B dhe J.K janë akuzuar për veprën penale të dhënies së ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale, në shkelje të nenit 305 paragrafit 2 të KPK-së, sepse, duke dhënë deklaratat të rreme në mbështetje të alibisë së mbrojtjes të E.Kt, ata ndihmuan E.Kn të shmangë zbulimin.

Termi kryerës do të thotë personi i cili ka kryer veprën penale dhe kundër të cilit është ndërmarrë procedura penale.

Sipas mendimit të gjykatës, fajësia e ndihmësit mund të vërtetohet pasi kryerësi të jetë gjetur fajtor nga gjykata – pra, kjo do të thotë se në radhë të parë duhet të përcaktohet fajësia e kryerësit kryesor dhe pastaj ekzistenca e ndihmës. Prandaj, për mendimin e gjykatës, përgjegjësia e ndihmësit është e lidhur drejtpërdrejt me rezultatin e procedurës penale kundër kryerësit.

Për këtë arsye, megjithëse të pandehurit MU.H, MI.H, N.H, N.B dhe J.K u paralajmëruan të gjithë, para se të jepnin deklaratat e tyre, se dhënia e deklaratave të rreme mund të përbëjë veprë penale dhe ata ishin qartësisht të vetëdijshëm për detyrimin e tyre për të treguar të vërtetën, ata nuk mund të gjenden fajtorë për veprën penale të dhënies së ndihmës kryerësit pas kryerjes së veprës penale, pasi kryerësi E.K u shpall jo fajtor nga gjykata.

Nga ana tjetër, gjykata është e mendimit se deklaratat e rreme gjatë hetimit normalisht duhet të përfshihen në krimet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me deklaratat e rreme. Megjithatë, neni 307 i KPK-së, i cili ka të bëjë me deklaratat e rreme të dhëna nga dëshmitarët, kufizohet në procedurën gjyqësore.

Gjykata gjen se procedura gjyqësore fillon me aktakuzën. Në këtë rast Aktakuza u ngrit më 30 mars 2011, pasi ishin dhënë deklaratat në fjalë, kështu që neni 307 i KPK-së nuk zbatohet.

Duke marrë parasysh të gjitha argumentet e mësipërme dhe përmbajtjen e nenit 396 paragrafi 9 të KPPK-së, gjykata është e detyruar të theksojë në arsyetim nenin 390 paragrafi 3 të KPPK-së si arsye e drejtpërdrejtë e lirimit nga akuza.

Nuk u provua se të pandehurit e kanë kryer aktin me të cilin ishin akuzuar.

Prandaj vendoset si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Sot më datë 1 shkurt 2013.

Gjyqtarja Mariola Pasnik
Kryetare e trupit gjykues

Gjyqtari Skënder Çoçaj
Anëtar i trupit gjykues

Gjyqtarja Teuta Krusha
Anëtare e trupit gjykues

Joseph Hollerhead
Proces-mbajtës

MJET LIGJOR: Në bazë të nenit 398(1) të KPPK-së, personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë kundër këtij Aktgjykimi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dorëzimit të këtij Aktgjykimi tek palët.